

UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНІВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

STUDIMET PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore

Drejtimi Administrim Publik

TEZA:

“BASHKËPUNIMI I NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE

RAST STUDIMI KOMUNA E GOSTIVARIT”

KANDIDATI:

Emrli Asani

MENTORI:

Assoc.prof. Fadil Zendeli

Tetovë, 2021

| | |
|---|-------|
| LËNDA E HULUMTIMIT..... | 3 |
| QËLLIMET E HULUMTIMIT..... | 4 |
| HIPOTEZAT..... | 5 |
| METODOLOGJIA E HULUMTIMIT..... | 6 |
| RËNDËSIA E PUNIMIT..... | 7 |
| APSTRAKT..... | 8 |
| APSTRACT..... | 9 |
| Kapitulli i parë | |
| Aspekte teorike mbi vetëqeverisjen lokale..... | 10 |
| 1.1 Nocioni..... | 10-15 |
| 1.2 Përkufizimi..... | 15-17 |
| 1.3 Ndarja Territoriale dhe raporti i pushtetit selektiv mbrenda vetit..... | 18-20 |
| 1.4 Aspektet financiare të vetëqeverisjes lokale..... | 21-23 |
| 1.5 Rëndësia e Qeverisjes lokale..... | 24-34 |
| 1.6 Karakteristikat themelore të Vetëqeverisjes Lokale..... | 35-39 |
| Kapitulli i Dytë | |
| Themelimi..... | 40-41 |
| Territori..... | 42 |
| Demografi..... | 43-44 |
| Simbolet..... | 45 |
| 1.1 Komuna e Gostivarit..... | 46-60 |
| 1.2 Bashkepunimi I Komunës së Gostivarit me Komunitat mbrenda vendit..... | 61-63 |
| 1.3 Bashkepunimi I Komunës së Gostivarit me Komunitat jashtë vendit..... | 64-65 |
| 1.4 Bashkepunimi I Komunës së Gostivarit me organet e pushtetit qendror..... | 66-67 |
| 1.5 Bashkepunimi I Komunës së Gostivarit me fondet dhe organizatat ndërkombetare..... | 68-73 |
| 1.6 Bashkepunimi I Komunës së Gostivarit me OJQ-te..... | 74-76 |
| SHQYRTIMET PËRFUNDIMTARE..... | 77 |
| LITERATURA..... | 78-79 |

LËNDA E HULUMTIMIT

(Arsyetim i propozim-Tezës së magjistraturës)

Një ndër fushat më të rëndësishme bashkëkohore të veprimtarisë konsideroj se është vetëqeverisja lokale dhe mu për këtë arsye më është shtuar dëshira që të merrem me një hulumtim që ka të bëjë me zhvillimin, organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në tëresi dhe Bashkëpunimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale në mënyrë të veçantë .

Me të drejtë thuhet se vetëqeverisja lokale është vendi ku qytetarët mund t'i realizojnë kërkesat e tyre me karakter lokal dhe se intencat e qytetarëve janë që në menyrë të pavarur, sa më shpejtë dhe me kosto sa më të ulët t'i realizojnë nevojat e jetës së përditshme.

Që të realizohet ky qëllim duhet të ekzistojë një bashkëpunim i mirëfillte i njësive të vetëqeverisjes lokale. Duke qenë banor i Komunës së Gostivarit, unë dëshiroj të merrem me hulumtimin e bashkëpunimit të njësive të vetëqeverisjes lokale konkretisht Komunën e Gostivarit..

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Hulumtimi ka të bëjë kryesisht me karakteristikat e vetëqeverisjes lokale në mënyrë të veçantë me bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Përpjekjet tona gjatë hulumtimit do të synojnë në gjetjen e shkaqeve që ndikojnë në zhvillimin, organizimin dhe funksionimin e mirëfilltë të Komunës së Gostivarit. Përveç kësaj, ne do të mundohemi t'i identifikojmë shkaqet që pengojnë bashkëpunimin e mirëfilltë të Komunës së Gostivarit me:

- komunat tjera mbrenda vendit ,
- komunat jashtë vendit (binjakëzimin e komunave),
- organet e pushtetit qendror (njësitë rajonale të Ministrive),
- fondet dhe organizatat ndërkombëtare (IPA, FARE, SOROS; UNESKO; FAO),
- OJQ –të etj.

HIPOTEZAT

Dhe që nga hulumtimi dhe rezultatet që do të arrihen, do të nxjerrim hipoteza se cilët faktor koheziv pengojnë bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Poashtu në të njëjten kohë do të theksojmë faktorët që mund ta përmirësojnë bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes lokale (Komunës së Gostivarit).

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Një nga çështjet me rëndësi për të qenë i suksesshëm ky hulumtim janë edhe metodat që do të përdoren si: metoda historike, sociologjike, krahasuese dhe empirike.

Përveç këtyre metodave, gjatë këtij hulumtimi do të përdoren një numër i teksteve Universitare të autorëve të ndryshëm si nga vendi ashtu edhe nga ato ndërkombëtar, Konventa ndërkombëtare, Kushtetuta dhe Ligjet që i referohen kësaj fushe, Statute të Komunave, Rregullore dhe akte të tjera. Punime të botuara nga autorë të ndryshëm lidhur me bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Hulumtimi në fjalë ka një rëndësi pasi që ka të bëjë, jo vetëm me çështje teorike por edhe me çështje empirike si dhe rekomandime lidhur me Bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Punimi përbëhet prej pjesës hyrëse dhe dy kapitujve.

Në kapitullin e parë bëhet fjalë për aspektet teorike të qeverisjes lokale dhe bashkëpunimin e vetëqeverisjes lokale.

Në kapitullin e dytë bëhet fjalë për Bashkëpunimin e Komunës së Gostivarit. Bashkëpunimi me komunat tjera mbrenda vendit, komunat jashtë vendit (binjakëzimin e komunave), organet e pushtetit qendror (njësitë rajonale të Ministrive), fondet ndërkombëtare (IPA, FARE, SOROS, UNESKO, FAO), OJQ –te etj.

Gjatë punës hulumtuese, do të jemi korrekt, serioz dhe mbi të gjitha të pavarur nga literatura dhe burimet që do të shfrytëzojmë.

APSTRAKT

Me qeverisje lokale nënkuptojmë nocion të decentralizimit, në gjuhën shqipe e hasim në disa kuptime si: bartje, zhvendosje, disloki, transfer, shkarkim, etj. Decentralizimi, në të vërtetë, kuptohet si proces i bartjes së kompetencave nga organet e pushtetit qendror në shkallë të caktuar të organeve joqëndrore të nivelit lokal.

Vetëqeverisja lokale ka të bëjë me përkufizimin, rëndësinë e qeverisjes lokale, dhe karakteristikat themelore të qeverisjes lokale ku sipas Redfield, vetëqeverisja lokale paraqet të arriturat e qytetarëve në kuadër të bashkësisë lokale ose përmes përfaqësuesit të tyre në funksione dhe autorizime të garantuara me ligj, ose në bazë të së drejtës së përgjithshme.

Vetëqeverisja lokale zë një vend të rëndësishëm në Kushtetutën e vitit 1991, ku rradhitet në një nga vlerat themelore të rendit kushtetues ekzistues. Me këtë kushtetutë, të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë u garantohet e drejta e vetëqeverisjes lokale.

Lindja e vetëqeverisjes lokale ndërlidhet me dukuritë e para të saj, pavarësisht se ajo si disiplinë shkencore paraqitet shumë më vonë, kur merr tiparet e një discipline të pavarur nga disiplinat e tjera shkencore, në kuadër të së cilave studiohej më parë dhe nga të cilat u shkëput në kushte dhe rrethana të reja të zhvillimit dhe të diferencimit të shkencës .

Vetëqeverisja lokale ku si rast studimi e kemi Komunën e Gostivarit që ka të bëjë me themelimin, territorin, simbolet, organet e Komunës së Gostivarit, organizimin dhe funksionimin, bashkëpunimin e Komunës së Gostivarit me Komunitat mbrenda vendit dhe jashtë vendit, bashkëpunimin me organet shtetërore me fondet dhe organizatat jashtë vendit dhe OJQ-të.

Komuna e Gostivarit është e themeluar dhe rajoni i saj është përcaktuar me Ligjin për organizimin territorial të vetvendosjes vendore në Republikën e Maqedonisë.

APSTRACT

By local government we mean the notion of decentralization. In Albanian we come across it in several ways such as: transfer, relocation, dislocation, transfer, dismissal, etc. Decentralization is, in fact, understood as the process of transferring competencies from central government bodies to a certain degree of decentralized [local level] organs.

Local government is concerned with the definition, importance of local government, and the basic characteristics of local government where, according to Redfield, local government represents the achievements of citizens within the local community or through their representative in the functions and powers guaranteed by law, or on the basis of general law.

Local self-government occupies an important place in the 1991 Constitution, which enshrines one of the fundamental values of the existing constitutional order. With this constitution, all citizens of the Republic of Macedonia are guaranteed the right to local self-government.

The emergence of local governance relates to its first occurrences, although it emerges as a scientific discipline much later, when it takes on the features of a discipline independent of other disciplines within which it was previously studied and disconnects under new conditions and circumstances of the development and differentiation of science.

Local self-government where as a case study we have the Municipality of Gostivar dealing with the establishment, territory, symbols, organs of the Municipality of Gostivar, organization and functioning, cooperation of the Municipality of Gostivar with Municipalities within the country and abroad, cooperation with state bodies with funds and organizations abroad and NGOs.

The Municipality of Gostivar is established and regulated by the Law on Territorial Organization of Local Self-Government in the Republic of Macedonia.

Kapitulli i parë

1.Aspekte teorike mbi vetëqeverisjen lokale

1.1 Nocioni

Sa i përket vetë nocionit të decentralizimit, në gjuhën shqipe hasim në disa kuptime, si: bartje, zhvendosje, disloki, transfer, shkarkim, etj. Decentralizimi, në të vërtetë, kuptohet si „proces i bartjes së kompetencave nga organet e pushtetit qendror në shkallë të caktuar të organeve joqëndrore [të nivelit local].

Në teori ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me kuptimin e decentralizimit. Disa autorë decentralizimin e lidhin me demokracinë dhe e indentifikojnë me të. Të tjerë mendojnë se decentralizimi nuk duhet të lidhet ngusht me demokracinë, ndërsa një grup tjetër e vështronë edhe në raport me centralizimin. Ka dhe autorë që decentralizimin e identifikojnë me vetëqeverisjen lokale. Ç’është e vërteta, decentralizimi dhe vetëqeverisja lokale kanë elemente të ngjajshme dhe të përbashëta dhe janë në raport të ngushtë me njëri-tjetrin, por megjithatë, janë dy nocione të ndryshme dhe dallojnë.

Organet qendrore ndaj organeve joqendrore mvaren nga ndikimi i tendencës së rritjes së shkallës së ndikimit decentralizimi krahas centralizimit që do të thotë, përkundër decentralizimit që kupton procesin e dobësimit të ndikimit të organeve qendrore ndaj organeve joqendrore.

Këto dy procese shfaqen dhe zhvillohen në sferën e raporteve funksionale në mes ‘qendrës dhe lokales’, jo vetëm në fushën e ndarjes së kompetencave, por edhe në fushat e tjera. Fusha e ndarjes së kompetencave është mjaft e rëndësishme për faktin se të përkufizuarit e decentralizimit varet nga volumi (sasia) e kompetencave të organeve lokale.

Lidhur me kompetencat, theksoj se centralizimi është ‘çdo anim kah nxerrja, zbatimi dhe kontrolli i vendimeve nga nivele të larta’, ndërsa decentralizimi është ‘tendecë e kryerjes së këtyre funksioneve nga ana e niveleve të ulta’.¹ Edhe pse decentralizimi shfaqet edhe në funksionin ligjvënës dhe në atë ekzekutiv të qeverisjes, para së gjithash ndeshet si proces që zhvillohet në funksionin administrativ.

¹ Ramljak Milan, Centralna i lokalna uprava u razvoju, Zagreb, 1982, faqe 97-99.

Tendeca është e arsyeshme për faktin se në kuadër të decentralizimit të funksioneve administrative, përfshihet edhe bartja e kompetencave administrative, organeve joshitetërore të vetëqeverisjes, të cilat nuk janë organe administrative në kuptimin e ngushtë të fjalës, por kryejnë punë administrative të caktuara.²

Decentralizimi nuk parqet vetëm çështje të raportit dhe dinamikës në mes organeve qendrore dhe joqendrore, po paraqitet edhe si formë e bartjes së funksioneve jo vetëm të një organi të subjektivitetit të njejtë, por edhe të personave të tjerë juridikë, ndërmarrjeve dhe institucioneve publike si subjekte juridike.

Edhe autori z, Tomas Henri për ndarjen e punës së centralizimit dhe decentralizimit tha se mund të kuptohet si proces , në mes të nivelit qendror dhe niveleve të ulta. Centralizimi shfaqet si tendencë e forcimit, ndërsa decentralizimi si tendencë e dobësimit të ndikimit të qendrës ndaj nivelit lokal, si në shkallën e ndërhyrjes në vendimarrje, zbatimin dhe kontrollin e akteve të nivelit më të ulët.³

E rëndësishme është që të bëhet dallimi në mes të kompetencave origjinere [burimore] dhe atyre të deleguarave [të besuarave], nga ana e organeve qendrore organeve lokale. Në grupin e parë bëjnë pjesë punët e organeve të pushtetit lokal të caktuara qysh më parë me dispozita juridike. Bëhet fjalë për punët, të cilat organet e pushtetit lokal i kryejnë dhe udhëheqin në mënyrë të pavarur, ndërkohë që organet e pushtetit qendror ushtrojnë vetëm kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë ndaj tyre. Në grupin e dytë të kompetencave bëjnë pjesë punët e organeve të pushteti qendror, të cilat për shkak të volumit, e me qëllim të ushtrimit më efikas etj. u besohen organeve të pushtetit lokal, të cilat i kryejnë, por megjithatë, nuk mund dhe të udhëheqin me to, që do të thotë se organet e pushtetit qendror ushtrojnë jo vetëm kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, por dhe kontrollin e gjithëmbarshtëm ndaj tyre.⁴ Si në aspektin organizativ, ashtu dhe atë funksional centralizimin dhe decentralizimin shprehës.

Decentralizimi organizativ është një koncept historik-tradicional i organizimit të shtetit juridik, i cili paraqet një "postulat për organizimin e decentralizimit dhe paraqet aspektin teknik" të tërësisë komplekse të raportit të organeve qendrore, si përfaqësues të një tërësie [shteti] dhe organeve joqendrore [organet e pushteti lokal], si përfaqësues të pjesës së veçantë të tërësisë.

Ekzistimi i organeve të nivelit qendror dhe të nivelit lokal flet për dy lloje organesh, të cilat kryejnë punë në dy nivele të organizimit të shtetit, si në ato të nivelit të lartë shtetëror ashtu dhe në ato të nivelit më të ulët.

² Pusiç Eugen, Nauko o pravi, Zagreb, 1979, faqe 129.

³ Tomiç Zoran, Upravno pravo, II Beograd, 1990, faqe 58.

⁴ Esat Stavileci, E drejta, Mbi decentralizimin si ide dhe koncept dhe mbi përparësitë dhe mangësitë e tij, Prishtinë, 1/2003

Punët origjinere (burimore) dhe punët e deleguara (të besuara) mund t'i kryejnë njësitë territoriale që do të thotë se kjo formë e decentralizimit teknik varet nga faktorë të ndryshëm, që janë të kushtëzuar nga numri i madh i punëve shtetërore, të cilat janë shumë komplekse, për ç'ka dhe paraqitet nevoja e diferencimit të tyre si punë me karakter lokal me qëllim që ato t'ju besohen organeve lokale.⁵

Si nevojë e kryerjes së punëve të caktuara në nivelin e ulët decentralizimi organizativ është pasojë për rregullimin e strukturës së nivelit joqendrore dhe numrit dhe madhësisë së njësisve territoriale, ku kryhen ato punë si dhe numrit dhe llojeve të organeve si bartëse të ushtrimit të atyre punëve.

Dallimi prej decentralizimit organizativ dhe decentralizimit funksional paraqitet si një lloj i raportit të organeve qendrore dhe joqendrore që doemos ndikon në funksionet drejtuese [udhëheqëse]. Shkalla e autonomisë së organeve të njësisve territoriale vërehet pikërisht në punën e organeve përfaqësuese të pushtetit lokal të cilat zgjidhen nga vetë qytetarët e atyre njësisve dhe të cilat i kryejnë punët në mënyrë të pavarur, ndërsa organet e pushtetit qendror ushtrojnë kontrollin e kushtetushmërisë dhe ligjshmërisë, por jo dhe kontrollin e gjithëmbarshtëm mbi organet e pushtetit lokal.

Edhe atë në fushën e administratës është e rëndësishme që të bëhet distinkcioni në mes të decentralizimit që paraqet "kualitet [cilësi] të caktuar të raporteve të shprehura në shkallë e ndikimit të organeve qendrore ndaj organeve lokale".

Organet e pushtetit qendror me ligj kanë të drejtë që administratës shtetërore, në kuadër të të drejtave dhe kompetencave të organeve qendrore. Bëhet fjalë për bartje të llojeve të caktuara të punëve administrative në vertikale, përkatësisht në mënyrë hierarhike [kryerja nga lart-poshtë], që nënkupton kryerjen e punëve nga organet më të ulta por jo edhe udhëheqjen e tyre.

Shihet qartë se këtu nuk bëhet fjalë për decentralizim të vërtetë, por më shumë për dekoncentrimin e punëve, për arsye se në decentralizimin e vërtetë punët administrative burojnë nga kompetencat origjinere.

Pushtetit lokal u japin mundësinë e ushtrimit të punëve në mënyrë të pamvarur (autonome) nga organet shtetërore ligjdhënëse bazuar në politikën e tyre jo vetëm në fushën e administratës por dhe të shërbimeve që ndryshe njihen si "punë të nevojave të qytetarëve".

⁵ Ramljak Milan, Aktuelni problemi centralizacije i decentralizacije, Zakonitost (Reforma lokalne samouprave), Zagreb, 1990, faqe 11-12.

Decentralizimin administrativ përveç decentralizim në kuptimin e plotë dhe të gjerë të fjalës si dhe volumin e ndeshim dhe në kuptimin më të ngushtë të tij.⁶

Bëhet fjalë për punët e karakterit lokal të cilat i kryen administrata e që dalin nga kompetecat origjinale [burimore] të saj.

Këto punë për shkak të racionalitetit dhe efikasitetit u besohen organeve të pushtetit lokal por nuk mund të udhëhiqen prej tyre dhe ndryshe quhen punë të dekoncentruara. Në kuptimin funksional ato janë punët të cilat i kryen administrata lokale edhe pse ato janë në fakt punë të organeve qendrore (me karakter qendror).

Në listën e gjerë të kompetencave, të deleguara dhe në ato të autorizuara, është siguruar edhe një listë "e gjerë" e të ardhurave financiare për financimin e atyre kompetencave, por me "fyt të ngushtë" në gjenerim fiskal.

Burimet vetjake, në fakt, gjithnjë sipas bindjes sonë të përcaktuara për financimin e kompetencave burimore sipas ligjit, as për së afërmi nuk mjaftojnë, si në vëllim ashtu edhe në strukture, para se gjithash për shkak të:

Normave të ulëta të tatimeve lokale, taksave dhe kompensimeve, si dhe për shkak të bazave të tyre edhe më të ulëta ato do të zbatohen (vlerat e nënvlerësuara); sistemet joefikase të arkëtimit të të ardhurave lokale; shprehisë jazhtzakonishtë të keqe dhe praktikës së menaxhimit me të ardhurat lokale etj.

Tatimi i përbashkët është pjesë e tatimit personal në të ardhura, sipas parimit të prejardhjes territoriale të burimit tatimor në kushte të ndryshimeve të skajshme të fondit të të punësuarve në qendrat urbane dhe rurale do të paraqitet debalans i skajshëm horizontal.

Te dotacionet e përgjithshme dhe destinuese ekziston risku i lartë në zbatimin e kriterit "të përshtatshmëris politike" dhe të kohabitimit të pushtetit qendror- i cili përpilon dhe zbaton kriteret edhe të pushteteve lokale që i kërkojnë mjetet financiare.

Përpos kësaj që u tha këtu, në propozim-ligjin e Qeverisë për financimin e vetëqeverisjes lokale ekzistojnë bile edhe disa dilema konceptuale.

Së pari, konceptualisht nuk janë të qëndrueshme më arsyetimet e përfaqësuesve të Qeverisë, se ,me transfere dhe donacione të Qeverisë prej buxhetit qendror dhe fondeve qendrore jashtë buxhetore do t i finacojnë gradualisht kompetencat e bartura nga niveli qendror në atë lokal, sepse kjo paraqet decentralizim të kushtëzuar, i cili së paku nuk do të jetë efikas, kurse për barazinë dhe drejtësinë e shpërndarjes as mos të ëndërrojmë!

⁶ Agni Aliu & Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Njoftim themelor dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë, Prishtinë, 2009, faqe 82

Donacionet janë sinonimi i vetëm për baraspeshën horizontale, ndërsa dotacionet finaciare janë vetëm instrument i barazisë finaciare të komunave me kapacitet fiskal të pamjaftueshëm, kurse decentralizimi i vërtet fiskal realizohet vetëm përmë sigurimit të burimeve vetijake për financimin e kompetencave burimore lokale.

Stuktura e miratuar e tatimeve dhe taksave lokale është shumë e ngjashme me ato të vendeve të zhvilluara, por sipas kapacitetit fiskal ato vende janë shumë larg prej tyre, sepse lartësia e disa normave të tatimeve lokale në shtetet e zhvilluara, si p.sh. norma e tatimit në pasuri, është edhe ⁷25 herë më e lartë se te ne. Edhe përkaj dispartitetit të normave, akoma nuk ekziston vend për ngritjen e këtyre normave tatimore, siç na këshilluan disa ekspertë ndërkombëtare, sepse ngarkesa e përgjithshme tatimore e qytetarëve tanë është në kufijtë e tolerances.

Si u tha dhe më lartë, në tërësi e identifikojnë vetëqeverisjen lokale me decentralizim duke menduar se punët publike ndahen në mes të organeve qendrore dhe atyre lokale sipas rëndësisë së tyre në atë mënyrë që njëri grup i punëve u përket kompetencave të organeve shtetërore ndërsa pjesa tjetër e kompetencave organeve lokale.

Punët e decentralizuara që u caktohen për t'i kryer dhe udhëhequr organet e pushtetit lokal janë punë që i përgjigjen tipit anglez të vetëqeverisje lokale, ndërsa punët të cilat kryhen dhe nuk udhëhiqen nga organet e pushtetit lokal i përkasin tipit të vetëqeverisjes lokale franceze dy nga katër tipet e mëdha të vetëqeverisjes lokale në botë.

Kur bëhet fjalë për decentralizimin përgjithësisht, pavarësisht sistemeve që zhvillohen në fushën e vetëqeverisjes lokale nisemi nga fakti se ekzistojnë punë të caktuara publike të cilat në mënyrë të natyrshme paraqiten si nevojë dhe interes i përbashkët i qytetarëve që jetojnë në bashkësi lokale dhe se ato kanë të drejtën burimore të vetëqeverisjes lokale. Kjo e drejtë burimore qytetarëve u garantohet me kushtetutë dhe me ligj.

Vërejtja tjetër që mund të theksohet kur bëhet fjalë për decentralizimin përgjithësisht është se sërish pavarësisht nga sistemet që zhvillohen në fushën e vetëqeverisjes lokale në raport me organet shtetërore, organet e decentralizuara kanë një shkallë të autonomisë (pavarësisë), e cila ndryshon në kohë dhe hapësirë të ndryshme. Kjo shkallë e autonomisë (pavarësisë) mund të vështrohet si në aspektin organizativ ashtu dhe në aspektin funksional.

Më në fund shkalla dhe dinamika e zhvillimit të procesit të decentralizimit varet nga vullneti i pushtetit qendror, por jo vetëm nga ai. Shkalla e autonomisë së pushtetit lokal varet nga parimet që ndërtohen në raportet e pushtetit qendror - pushtetit lokal dhe shkalla e demokratizimit të tyre.

⁷ Nazmi Maliqi –Proceset e Integritit Euroatlantik dhe Republika e Maqedonisë fq.48

Disa autorë nocionin e autonomisë (pavarësisë] së pushtetit lokal e lidhin me vetëqeverisjen si model intergrues për realizimin e të drejtave politike të qytetarëve, ndërsa decentralizimin e shohim si proces të bartjes së kompetencave të organeve qendrore në organet lokale ndaj të cilave pushteti qendror duhet të jetë i hapur në përputhje me parimin kushtetues dhe të drejtën e vetëqeverisjes së qytetarëve që bazohen në aktin më të lartë juridik të një vendi.

Decentralizimi nuk kupton vetëm aspektin organizativ të bartjes së kompetencave nga pushteti qendror në organet lokale, por edhe aspekti funksional i cili shprehet si tendencë në vendosjen e raporteve të ndërsjellta në mes të organeve të pushtetit qendror dhe atyre të pushtetit lokal.⁸ Për ta kuptuar më mirë thelbin e decentralizimit është mirë që ai të vështrohet në raport me demokracinë, me centralizmin, me dekoncentrimin dhe me rajonalizimin. Decentralizimi është në raport të ngushtë, por dhe shumë pika dalluese me to, që e bën decentralizimin një kuptim më vetë.

1.2 Përkufizimi

Vetëqeverisja lokale në sisteme të ndryshme dhe në vende të ndryshme me rregullim të ndryshëm shoqëror nuk ka pozitë dhe rëndësi të njëjtë, që do të thotë se ekzistojnë dallime si në statusin, ashtu dhe në shkallën e qeverisjes së njësisë të pushtetit lokal, të cilat vërehen qysh në përkufizimin e kuptimit të vetëqeverisjes lokale dhe të terminologjisë që përdoret në gjuhë të ndryshme të botës, për të cilën u bë fjalë në kapitullin e mëparshëm.

Për përkufizimin e kuptimit të vetëqeverisjes lokale është evidentuar një mori përpjekesh, por do të ndalemi vetëm në disa prej tyre.

Vetëqeverisja lokale paraqet të arriturat e qytetarëve në kuadër të bashkësisë lokale ose përmes përfaqësuesit të tyre në funksione dhe autorizime të garantuara me ligji, ose në bazë të së drejtës së përgjithshme.

Poashtu paraqet ekzistimin e një bashkësie territoriale, e cila i ka të parapara me ligj disa të drejta dhe nevoja për organizimin dhe rregullimin e punëve të veta.

Bashkësitë lokale përcaktohen edhe si pushtete të vetëqeverisjes, që gëzon shkallë të caktuar të lirive gjatë realizimit dhe zbatimit të të drejtave dhe obligimeve vetanake. Pushteti

⁸ Agni Aliu & Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Njoftim themelor dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë, Prishtinë, 2009, faqe 82-83

lokal zbatohet në një territor të kufizuar të shtetit nga ana e organeve që e përfaqësojnë vetëqeverisje lokale.

Autorë të ndryshëm theksojnë se elemene të vetëqeverisje lokale janë:

- a) vetëqeverisja lokale si kategori kushtetuese;
- b) vetëqeverisja lokale si organizatë politike vetëqeverisëse e bashkësisë lokale; me të drejtë për zgjidhjen e drejtpërdrejtë të çështjeve me interes për vetë bashkësinë lokale;
- c) vetëqeverisja lokale si e drejtë për pjesëmarrjen direkte të qytetarëve etj.⁹

Si rrethanat e kësaj, mund të konkludojmë se vetëqeverisja lokale ka disa karakteristika të përgjithshme të caktuara të saj.

Karakteristika e parë e vetëqeverisjes lokale është qenia e asaj kategorie të sistemit politik që e nënkupton atë si formë të qeverisjes lokale në bashkësitë lokale, ku qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose përmes organeve përfaqësuese dhe organeve të tjera që i zgjedhin vetë, vendosin për interesat dhe punët me rëndësi vendore në sfera të caktuara të jetës shoqërore në bashkësinë lokale.¹⁰

Mirëpo, për të qenë vetëqeverisja lokale e vërtetë duhet të plotësohen edhe disa kushte themelore: së pari duhet të ketë mbështetje kushtetuese dhe ligjore, dmth. të ketë status kushtetues dhe ligjor, pra të garantohet me kushtetutë dhe ligj.

Parimi i përfshirjes së vetëqeverisjes lokale në kushtetutë dhe ligj parashihet me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. Shtetet që e kanë ratifikuar atë, obligohen që të ketë garanci kushtetuese e ligjore për vetëqeverisjen lokale.

Garantimi kushtetues e ligjor e bën vetëqeverisjen lokale njëkohësisht një institucion kushtetues e ligjor. Vetëqeverisja lokale, historikisht, paraqitet si një organizatë në bazë të pushtetit. Në shumë shtete paraqitet jo vetëm si formë e kufizimit të centralizimit, por si e pavarur nga organet e pushtetit qendror.

E drejta e vetëqeverisjes lokale nënkupton të drejtën e qytetarëve të vetëvendosin për punët me karakter lokal.¹¹

Vetëqeverisja lokale nënkupton të drejtën dhe aftësinë e organeve lokale që në kuadër të ligjit, t'i rregullojnë dhe të udhëheqin punët e rëndësishme publike''.

⁹ Djordjeviç Jovan, Politički system, Beograd, 1977, faqe 29.

¹⁰ Lukiç Radomir, Teorija države i prava, Beograd, 1976, faqe 298.

¹¹ Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, e nxjerr më 15.10.1985 në Straburg.

E drejta e banorëve të bashkësisë lokale realizohet përmes këshillave ose kuvendeve të përbërë nga anëtarë të zgjedhur në zgjedhjet e përgjithshme të lira me votim të fshehtë, me të drejtë vote të barabartë.

Me vetëqeverisje lokale theksohet se pjesëmarrja direkte e banorëve lokalë në organizimin dhe udhëheqjen e punëve publike është e mundur pikërisht në nivelin lokal.

Në shtetet me vetëqeverisje tradicionale kryhen punë me interes të drejtpërdrejtë të banorëve që jetojnë në territorin e bashkësisë lokale. Prandaj këto punë quhen punë me rëndësi lokale.

Përderisa organet shtetërore kanë të drejta dhe detyrime të kujdesen për nevojat e përgjithshme në gjithë territorin e shtetit në bashkësitë lokale së pari zgjidhen problemet e jetës së përditshme kështu që është e logjikshme që me ato punë të merren organet e pushtetit lokal.

Rregull e përgjithshme është që disa punë të jenë në kompetenca të organeve lokale dhe një pjesë tjetër t'u takojë organeve qendrore. Grupi i parë i punëve paraqet një burim të rëndësishëm të fushëveprimit të organeve të vetëqeverisjes lokale. Grupi i dytë i punëve kryhet nga organet qendrore edhe atë në dy mënyra:

1. Përmes njësive rajonale të organeve qendrore, ose
2. përmes delegimit të punëve të organeve të pushtetit lokal(në pyetje është decentralizimi)

Punë lokale janë të gjitha ato punë që me kushtetutë ose ligj nuk janë të parapara si punë të pushtetit qendror.

Edhe pse për vetëqeverisjen lokale thuhet se të drejtat themelore dhe detyrat e organeve lokale duhet të parashihen me kushtetutë dhe ligj, kjo nuk do të thotë që disa të drejta dhe detyrime të mos transferohen nga organet qendrore në ato lokale.¹²

Një ndër çështjet me rëndësi për vetëqeverisjen lokale është çështja e ndarjes territoriale të shtetit në një njësi lokale dhe rregullat për atë ndarje.

¹²Po aty, neni 4.

1.3 Ndarja Territoriale dhe raporti i pushtetit selektiv mbrenda vetit

Duhet pasur parasysh disa faktorë kur bëhet fjalë për ndarjen territoriale si: sipërfaqja e territorit të bashkësisë lokale; numri i popullatës; kufijtë e interesit lokal etj. Duhet pasur parasysh njëkohësisht edhe homogjenitetin, gravitimin e punëve kah disa institucione të rëndësishme (spitalet, shkollat, universitetin dhe kapacitetet ekonomike financiare të vetëqeverisjes lokale).

Ndarja territoriale bëhet me akt shtetëror ose me ligj, por paraprakisht konsultohet popullata lokale. Kjo është metoda që sugjeron Karta Evropiane për Vetëqëvërisje Lokale ku thuhet se “kufijtë e njësive të vetëqeverisjes lokale nuk mund të ndryshohen pa konsultimin paraprak të bashkësive lokale.¹³

Pushteti lokal ka të drejtë që të rregulloj strukturën e brendshme dhe ta aftësojë atë për nevojat lokale që të ketë udhëheqje efikase lidhur me organizimin e administratës si dhe burimet e mjeteve për kryerjen e punëve të pushtetit lokal, u garanton njësive lokale” të drejtën për organe të veta dhe kuadrin e punësuar në to”.¹⁴

Një ndër çështjet me interes për vetëqeverisjen lokale është raporti i saj me shtetin. Në të vërtetë, organizimi dhe pavarësia e institucioneve lokale dhe vetëqeverisjes lokale në përgjithësi, varet nga parimet në bazë të të cilave vendoset raporti i organeve të shtetit dhe vetëqeverisjes lokale.

Vetëqeverisja lokale nënkupton pavarësinë në udhëheqjen e organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale në raport me organet qendrore të pushtetit shtetëror.

Ajo është edhe elementi i rregullimit shtetëror që manifestohet sidomos me rastin e kryerjes së disa punëve shtetërore të besuara nga organet qendrore të pushtetit shtetëror edhe pse shpreh të drejtën e qytetarëve për qeverisje territoriale të bashkësive lokale.

Për tu rregulluar raporti i vetëqeverisjes lokale me organet qendrore të pushtetit shtetëror ekzistojnë tri mundësi:

1. Pavarësia e plotë e njësive të vetëqeverisjes lokale (siç e paraqiste teoria markiste e komunave);

¹³Po aty, neni 5.

¹⁴Po aty, neni 6.

2. Pavarësia jo e plotë e vetëqeverisjes lokale që shprehet vetëm në nivelin lokal të pushtetit shtetëror (siç ekziston në shtetet centraliste);
3. Sistemi i përzier sipas të cilit njësitë e vetëqeverisjes lokale për kryerjen e disa punëve gëzojnë pavarësi të plotë, ndërsa për disa kanë varshmëri nga pushteti shtetëror (shtetet decentraliste)

Që të gjitha sistemet e vetëqeverisjes lokale kanë theksuar qartë kufirin e të drejtës së vendosjes në kryerjen e punëve me karakter lokal nga ana e organeve të pushtetit vendor dhe të drejtës së organeve për mbikqyrjen në kuptim të ligjshmërive dhe shpesh dhe në kuptim të oportunitetit.

Nën mbikqyrjen e organeve të pushtetit qendror, organet e pushtetit vendor duhet t'i kryejnë në mënyrë të pavarur punët që janë caktuar me ligj, .

Organet e pushtetit qendror disponojnë instrumente me të cilat bëjnë mbikqyrjen dhe ushtrojnë ndikim në organet e vetëqeverisjes lokale si; kontrolli financiar, emërimi i nëpunësve, informimi për punën etj. Kur organet e pushtetit vendor kryejnë punë të besuara nga ana e organeve të pushtetit qendror, ato i nënshtrohen një kontrolli hierarkik të organeve qendrore.

Pra, në kuadër të punëve me karakter lokal. Ato janë të pavarura, ndërsa në kuadër të punëve me karakter shtetëror janë në varshmëri të organeve qendrore lidhur me rregullimin e mbikqyrjes ndaj punëve të organeve të njësisve lokale, thuhet se duhet pasur parasysh dallimin mes sistemit të punëve vetanake dhe të besuara..¹⁵

Por, në të dyja rastet qëllimi qëndron në sigurimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së punës së organeve të pushtetit vendor, që do të thotë se të gjitha mbikqyrjet mbi punën e organeve të pushtetit vendor duhet të bëhen në pajtim me procedurat e parapara me kushtetutë dhe ligj. Veç kësaj, qëllimi tjetër është që të arrihet pajtueshmëri e punës së organeve të pushtetit vendor me parimet e kushtetutës dhe ligjin.

Mbikqyrja e organeve shtetërore bëhet në atë mënyrë që të sigurohet ndërhyrja e organit mbikqyrës, ashtu që mbikqyrja të jetë në përputhje me interesin që duhet ta mbrojë. Më në fund një element tjetër i rëndësishëm i përkufizimit të vetëqeverisjes lokale është dhe mbrojtja ligjore e saj. Organet vendore duhet të gëzojnë mjete juridike për ushtrimin e lirë të funksioneve dhe të respektimit të parimeve të parapara me kushtetutë ose me ligj të shtetit të vet'. Pra, mbrojtjen ligjore duhet ta sigurojë shteti. Shtrohet pyetja se si mund ta bëjë shteti mbrojtjen ligjore? Ajo arrihet të bëhet në procedurat e gjykatave të rregullta të gjykatave kushtetuese të gjykatave të

¹⁵Po aty, neni 19.

veçanta ose gjykatave administrative varësisht se si është e rregulluar mbrojtja ligjore në shtetet përkatëse.¹⁶

Në aspektin teorik vlerësohet se ka më shumë shtete në botë tek të cilat vetëqeverisja lokale bartet në plan të dytë në raport me shtetin dhe pushtetin shtetëror i cili e merr mbi vete rregullimin e disa çështjeve të rëndësishme për ekzistencën e qytetarëve.

Por si më të rëndësishme theksohen:

- Zgjerimi i rolit të shtetit bashkëkohor, në aspektin teorik vlerësohet se ka më shumë shtete, në të cilat nuk shfaqin interesim për politikën lokale;
- Kalimi i shumë punëve, të cilat më parë kryheshin nga ana e pushtetit vendor në kompetenca të pushtetit shtetëror;
- Ngushtimi i pavarësisë së vetëqeverisjes lokale, e cila vlerësohet nga donacionet dhe subvencionet e shtetit;
- Ngushtimi i pavarësisë së vetëqeverisjes lokale nga aspekti normativ;
- Zvogëlimi i hapësirës së vetëqeverisjes për nevojat e punëve publike të veçanta (shëndetësia, arsimit, komunikacioni etj.)

Këto janë disa veti të shteteve ku vetëqeverisja lokale ka mbështetje të vogël, por nga ana tjetër, ekziston dhe taborri i shteteve ku vetëqeverisja lokale ka një rëndësi të veçantë. Aty bëhet fjalë për një vetëqeverisje lokale demokratike të vërtetë.

Një rol të rëndësishëm për zhvillimin e vetëqeverisjes lokale luan edhe vetë Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Prej aty janë përcaktuar dhe përpunuar elementet më të rëndësishme të statusit të vetëqeverisjes lokale, fakt që shënon një kontribut lidhur me unifikimin e përmbajtjes së vetëqeverisjes lokale në shtete të caktuara të Evropës, që e bën dhe "ndërkombëtarizimin e vetëqeverisjes lokale".

Numri i shteteve që e kanë ratifikuar dokumentin është në rritje të sipërm. Detyrim i tyre është që t'u përmbahen parimeve kryesore të tij.

¹⁶Po aty, neni 11.

1.4 Aspektet financiare të vetëqeverisjes lokale

Për t'u kryer me sukses punët me karakter lokal, duhet që jo vetëm vetëqeverisja lokale, por edhe organet e bashkësive lokale, të disponojnë me mjete në mënyrë të pavarur. Në qoftë se organet e pushtetit vendor nuk i kanë të siguruara mjetet financiare, atëherë nuk mund të pritët që të realizohet me sukses vetëqeverisja lokale.

Burimet e mjeteve financiare të komunave parimisht duhet të jenë ekuivalente dhe të konsistojnë me kompetencat burimore që kështu të sigurohet autonomia fiskale dhe përgjegjësia e tyre. Komunitat në këtë rastë nuk kanë forcë gjeneruese fiskale për ti përmbushur kërkesat e tyre, komuna përbëhet nga këta të ardhurave ekzistuese:

a) të ardhurat vetanake:

-tatimet lokale (tatim në pasuri, tatim në trashëgimi dhe peshqesh, tatim në qarkullimin e patundshmërive të tjera të përcaktuara);

-taksat lokale (komunale, administrive dhe të tjera);

-kompensimet lokale (për rregullimin e tokës ndërtimore, për rregullimin e planeve hapësinore dhe urbanistike, për veprimtari të caktuar komunale, etj);

-të ardhurat nga pronësia (prej qerasë, interesave, shitjes së pasurisë, etj) dhe

-të ardhurat nga donacionet, saksionet në para, vetëkontributet, huazimet

-deri në nivelin e miratuar prej pushtetit qendror dhe të ardhurat e tjera.

b)të ardhurat prej tatimit personal në të ardhurat si tatim i përbashkët-

vetëm të ardhurat të caktuara që janë pjesë e tatimit personal të përgjithshëm, si:

-3% prej tatimit personal në të ardhura nga paga e personave fizik-të arkëtuar në vitin vijues në territorin e komunës ku detyruesit e kanë vendbanimin ose vendqëndrimin e tyre dhe -100% e tatimit personal në të ardhura të arkëtuara prej personave të regjistruar fizik dhe prej atyre që kryejnë veprimtari në territorin e komunës.

c)dotacionet të buxhetit qendrore (të Republikës) dhe të fondeve, si:

-dotacioni i përgjithëm në lartësi prej 3% i të ardhurave të përgjithshme të arkëtuara në vitin paraprak nga TVSH-ja, që shërben për financimin e të gjitha kompetencave të komunës pa përcaktimin paraprak të qëllimit, ku se sipas kriterëve të të ardhurave për kokë banori për 50%

¹⁷të shumës së dotacionit dhe 50%-shi tjetër sipas kriterëve që do t i përcaktojn Qeverija e R.Maqedonisë dhe

-dotacionet destinuese në formë të transfereve si dotacion destinues, capital, bllok, si dhe për kompetenca të deleguara që çdo vit përcaktohet në buxhetin Republikës dhe në buxhetet e fondeve .

-Dotacionet bllok do të destinohen për financimin e aktiviteteve të kulturës (veprimtarive e enteve kulturore dhe projekte të kulturës), mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve,arsimi (fillor dhe i mesem) dhe mbrojtja shëndetësore primare.

Tërësinë e mjeteve financiare e përbëjnë:

1. Mjetet që e kanë burimin nga njësitë lokale, dhe
2. Mjetet financiare që i siguron shteti(me c'rast shteti nuk mund të ushtrojë edhe mbikqyrjen se si do të shpenzohen ato mjete).

Nuk ka dyshim se mbikqyrja nga ana e pushtetit qendror në pushtetin lokal, prek në autonominë e vetëqeverisjes lokale.

Prandaj, për vetëqeverisje lokale, në mënyrë shprehimore, rregullohet çështja e burimeve financiare, ku theksohet se; pushteti vendor, në pajtim me politikën ekonomike të vendit, ka të drejtë të disponojë me mjete financiare vetanake të caktuara në kuadër të autorizimeve të veta.¹⁸ Burimet e mjeteve financiare parashihen me kushtetutë dhe ligj. Një pjesë e mjeteve financiare sigurohen nga taksat vendore dhe format e tjera, por për të qenë burimet sa më të shumta dhe sa më elastike, duhet të mirren masa për financim të barabartë. Ato masa nuk duhet që ti ngushtojnë autorizimet e organeve të pushtetit vendor.

Mjetet që u dedikohen organeve të pushtetit vendor nuk duhet të kenë karakter të fiksuar në mënyrë që të mos çënohet e drejta e organeve vendore për të udhëhequr politikën në kuadër të autorizimeve të veta, si dhe që të mundësohen kredi për investime kapitale dhe t'u bëhet e mundëshme pjesëmarrja në tregun nacional të kapitalit.

Përvoja evropiane në aspektin e financimit të organeve vendore, flasin për zgjidhje të njejtja, ashtu që: një pjesë e mjeteve sigurohet nga ana e buxhetit shtetëror, ndërsa pjesa tjetër sigurohet nga të ardhurat e vetë organeve vendore.

Në shtete të ndryshme pjesëmarrja nuk është e njëjtë, edhe pse rregull është që të sigurohet një mundësi financiare e barabartë e vetëqeverisjes lokale, që të bëhet e mundur një përmbushje e barabartë e nevojave në kuadër të kornizës së organeve vendore. Ajo mund të sigurohet nëpërmjet të standardeve të miratuara për nevoja të caktuara.

¹⁷ Nazmi Maliqi fq.47

¹⁸ Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, e nxjerr më 15.10.1985 në Straburg , neni 20.

Veçanërisht kur shtrohet çështja e efikasitetit të tyre për formimin dhe shpenzimin e mjeteve, organet vendore janë të pavarura, por njëkohësisht i nënshtrohen dhe mbykqyrjes së organeve qendrore.

Sa më shumë që të rritet vëllimi i punëve të organeve vendore, aq më shumë lind nevoja për shpenzime të mëdha, d.m.th., rritet varshmëria për subvencione dhe dotacione qendrore.

Pa dyshim në përkushtimin e vetëqeverisjes lokale S'ka dyshim se lidhja e marrëveshjes të njësive të vetëqeverisjes lokale mes tyre, në kuadër të shtetit ose dhe me njësi të vetëqeverisjes lokale ndërkombëtare, ndikon në zhvillimin e vetëqeverisjes lokale.¹⁹ Duhet theksuar se mund të bëhet binjakëzimi në mes të njësive lokale të të njëjtit shtet si dhe i njësive lokale të shteteve të ndryshme.

Në vetëqeverisje lokale lidhur me bashkimin e njësive lokale, theksohet: "organet vendore gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, kanë të drejtë që, si rezultat i pavarësisë së tyre, të bashkëpunojnë me organe të njësive të tjera lokale në kuadër të parashikimit ligjor për të kryer disa punë me interes të përbashkët". Gjithashtu, pushteti lokal ka të drejtë që siç është e paraparë me ligj të bashkëpunojë me pushtetet lokale gjegjëse të një shteti tjetër.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë dy burime kryesore për finansim. Në grupin e parë bëjnë pjesë të ardhurat burimore të caktuara me ligj:

- tatimet (një pjesë nga tatim fitimi, tatimi i pasurive të lëna në trashëgim dhe dhuratave të pasurive të patundshme);
- taksat e tokës komunale, taksat komunale dhe të ardhurat nga shërbimet;
- të ardhurat nga pasuritë e veta;
- të ardhurat tatimore republikane ose nga jashtë (në mall ose para)
- fitime nga ndërrmarjet dhe shërbimet publike të formuara nga njësia e vetëqeverisjes lokale;
- të ardhurat nga gjoba për mosrespektimin e rregullave të njësisë së vetëqeverisjes lokale;
- të ardhura tjera të parapara me ligj

¹⁹ Pusiç Eugen, Opsti citati, Zagreb, faqe 1294.

1.5 Rëndësia e Qeverisjes lokale

Vetëqeverisja lokale zë një vend të rëndësishëm në Kushtetutën e vitit 1991, ku rradhitet në një nga vlerat themelore të rendit kushtetues ekzistues.²⁰ Me këtë kushtetutë, të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë u garantohet e drejta e vetëqeverisjes lokale.²¹

Me kushtetutë, komunat shpallen si njësi të vetëqeverisjes lokale me të drejtë të themelimit të zyrave të vendit. Financimi i komunave mund të bëhet nga burimet e të ardhurave vetanake të komunave dhe nga buxheti i Republikës. Ndarja territoriale bëhet me ligj të veçantë, ndërsa qytetarët marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të tyre, në vendosjen për çështjet me rëndësi lokale, sidomos në fushat e shërbimeve publike, urbanizmit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit ekonomik lokal, financimit lokal, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, arsimit, shëndetësisë dhe fushave tjera të parapara me ligj.²²

Me këtë ligj Maqedonia bën edhe një hap përpara, duke e mbështetur vetëqeverisjen lokale dhe duke e përfshirë atë si kategori të sistemit politik. Ky ligj në mënyrë të detajuar e rregullon vetëqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë. Me të rregullohen kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimarrje, organizimi dhe puna e organeve të pushtetit lokal, mënyra e financimit të njësive të vetëqeverisjes lokale, përdorimi i gjuhëve dhe disa çështje të tjera me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.

Kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale janë të përfshira me Kushtetutën e vitit 1991²³ dhe me Ligjin për vetëqeverisjen lokale të vitit 1995, ndërsa me status të komunës rregullohen punët ose aktivitetet me karakter lokal, që nuk janë të përfshira në kompetencat e organeve të pushtetit qendror.

Vetëqeverisja lokale një numër të punëve i kryen në mënyrë të pavarur (punët konkrete), një numër punësh i kryejnë në pajtim me organet kompetente të pushtetit shtetëror (punët e caktuara), kurse pjesën tjetër të punëve organet e pushtetit shtetëror ua besojnë organeve të pushtetit lokal (punët e deleguara).

Për ti kuptuar mirë kufijtë e pavarësisë së kompetencave të njësive të vetëqeverisjes lokale, do ti përmendim më poshtë shkurtimisht ato punë që nuk mund t'i kryejnë njësitë e vetëqeverisjes lokale, siç janë: pushteti gjyqësor (nuk kemi gjyqtarë lokal, por kemi gjyqtarë publik), dmth. funksioni i gjykatave rregullohet nga qendra dhe jo nga organet e pushtetit lokal.

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Neni 8.

²¹ Po aty, Neni 114.

²² Po aty, Neni 115.

²³ Po aty, 1991, Neni 115.

Duke u bazuar para dhe gjatë luftës së vitit 2001 ekziston shkallë e lartë e konsensusit për nevojën aq të madhe të decentralizimit të shtetit më të centralizuar në Europë, por realizimi i procesit të decentralizimit ishte dhe mbetet ndër më kontestuesit dhe sot e kësaj dite.

Vetëqeverisja lokale është një formë e udhëheqjes së bashkësive lokale, ku qytetarët në mënyrë direkte ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur nga vetë ata, vendosin për interesat dhe punët me rëndësi lokale. Pavarësisht faktit, që trajton kryesisht vetëm çështjet administrative, ajo është kategori e sistemit të përgjithshëm politik dhe nuk mund të konsiderohet si zbulim administrativ.

Pretendimi i sistemeve bashkëkohore politike është, që, udhëheqja lokale të përputhet me bashkësinë lokale si bashkësi reale në kuptimin social, dhe për këtë arsye zgjidhje ideale është që vetëqeverisja lokale të përputhet me vendbanimin, me pjesët e vendbanimit, gjegjësisht me disa vendbanime të lidhura si bashkësi reale. Numri i shërbimeve dhe i organizatave profesionale, të cilat kënaqin një numër më të madh të nevojave të banorëve në hapësirën lokale, në shoqëritë e zhvilluara, vazhdimisht po rritet. Por, ka disa vende ku mbizotëron koncepti i “shtetit” dhe ku bashkësia lokale dhe vetëqeverisja lokale janë vetëm forma më të ulëta të ndarjes administrativo-territoriale të shtetit.

Sistemi i vetëqeverisjes lokale nuk është një koncept abstrakt, por konkret dhe publik, i cili bazohet dhe ndërtohet mbi faktorë përcaktues për organizimin dhe funksionimin e një njësie të vetëqeverisjes lokale, siç janë: territori i caktuar, konfiguracioni gjeografik dhe qytetarët.

Studimi për vetëqeverisjen lokale është i rëndësishëm dhe ka një impakt të drejtpërdrejtë në organizimin dhe funksionimin e saj mbi bazën e parimeve demokratike, te akademikët, autoritetet lokale dhe te ato qendrore.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk kanë asnjë lloj pushteti sa i përket mbrojtjes dhe politikës së jashtme. Nuk mund të mbajnë marrdhënie me shtetet tjera, nuk mund të nxjerrin akte normative në lidhje me rendin publik, nuk mund t’i urdhërojnë forcat publike të shtetit.

Edhe normat nga sferat e të drejtës civile dhe penale, janë në kompetenca ekskluzive të shtetit dhe vlejné për gjithë territorin e shtetit.

Organet e pushtetit lokal nuk kanë asnjë të drejtë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të individit, përveç se të bëjnë sa është e mundur dhe në kompetencën e tyre, sigurimin dhe rrespektimin e këtyre të drejtave dhe lirive.

Në vazhdim, do të përmendim disa punë konkrete që njësitë e vetëqeverisjes lokale mund t’i bëjnë në mënyrë të pavarur si psh: mund ta sjellin programin për zhvillim, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare, programin për rregullimin e tokës për ndërtim, të kryejnë punët për rregullimin dhe përdorimin e tokës për ndërtim, të kryejnë punët për rregullimin dhe përdorimin e tokës për ndërtim sipas ligjit, t’i caktojnë zonat dhe të mbledhin taksat e tokës, ta rregullojnë

dhe organizojnë ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale, lagjeve dhe objekteve të infrastrukturës me rëndësi lokale, rregullojnë furnizimin me ujë të pijshëm dhe vaditje, pastrimet publike, elektrifikimin publik, pastrimin e parqeve dhe sipërfaqeve me rëndësi lokale, rregullimin e udhëtimit të qytetarëve, mirëmbajtjen e sinjaleve të komunikacionit, rregullimin e tregjeve publike dhe shfrytëzimin e tyre, mirëmbajtjen e varrezave dhe mënyrën e shfrytëzimit, rregullimin dhe shfrytëzimin e vendparkimeve, mund të formojnë mjete të informimit me rëndësi lokale, për krijimin e shkollave të mesme profesionale në pajtim me ligjin, të japin mendim me rastin e hapjes së shkollave tetëvjeçare si dhe t'i financojnë ato në nivelin që e siguron Republika, të kryejnë iniciativa, të japin mendime dhe propozime për zhvillimin e rrjetit dhe institucioneve kulturore, sportive, mbrojtjen sociale të fëmijëve, të parashkollorëve, të mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjes së kafshëve dhe bimëve, mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit jetësor.²⁴

Punët që i kryejnë njësitë e vetëqeverisjes lokale në pajtim me organet kompetente të administratës shtetërore janë: nxjerrja e planit gjeneral të urbanizmit, për të cilin organi i administratës shtetërore kompetente për urbanizmin e jep pëlqimin, nxjerrja e planit urbanistik detal dhe dokumentet e urbanizmit për vendet e banuara të njërive të vetëqeverisjes lokale, për të cilin organi kompetent i administratës për urbanizëm jep pëlqim pasi paraprakisht t'i ketë konsultuar mendimet e organit dhe organizatave të parapara me ligj.²⁵ Mosmarrëveshjet e njërive vetëqeverisëse lokale dhe organeve të pushtetit qendror i zgjedh gjykata kompetente (Gjykata Kushtetuese). Ndërsa konfliktet mes njerëzve të vetëqeverisjes lokale do të zgjidhen nga gjykatat e rregullta.

Republika mund t'u besojë njërive të vetëqeverisjes lokale edhe një numër të caktuar të punëve që janë në kompetenca të organeve të administratës shtetërore, me qëllim që në mënyrë sa më efikase dhe racionale të realizohen të drejtat dhe detyrat e qytetarëve për përmbushjen e disa nevojave të caktuara në interes të qytetarëve. Gjatë dhënies së detyrave duhet pasur parasysh: madhësia, numri i banorëve, zhvillimi ekonomik, dhe veçoritë e njësisë së vetëqeverisjes lokale. Mjetet për kryerjen e punëve të besuara i siguron Republika. Ajo bën mbikqyrjen e kryerjes së atyre punëve për qëllimet e dedikuara.²⁶

Pushteti lokal duhet ti kushtoj një rëndësi të veçantë, se pa finansim të njërive të vetëqeverisjes lokale nuk mund të kemi organizim dhe funksionim të mirëfilltë të organeve.

²⁴ Ligji i vetëqeverisjes lokale i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 1995, Neni 17.

²⁵ Po aty, 1995, Neni 18.

²⁶ Po aty, Neni 19.

Vetëqeverisja lokale është pjesë integrale e sistemit politik dhe kushtetues. Kjo, për faktin se mënyra dhe niveli i qeverisjes lokale është i përcaktuar dhe rregulluar nga shumica e kushtetutave të shteteve. Ndarja administrative lokale përcaktohet që në aktin themeltarë të krijimit të një shteti, që është kushtetuta. Se sistemi i vetëqeverisjes lokale edhe në aspektin organizativ, funksional të kompetencave dhe të përgjegjësive në tërësi është kategori kushtetuese.

Rregullimi nga ana kushtetuese e procesit administrativ dëshmon se është e garantuar e drejta e njerëzve në bashkësi të caktuara territoriale, që në mënyrë të mëvetëshme të qeverisin me punët e bashkësisë në mënyrë të drejtpërdrejtë. (Salihu. K, 2004:20) pavarësisht nga organizimit të sistemit politik, qeveritë lokale janë të pavarura të ushtrojnë funksionet, të drejtat dhe obligimet e tyre në harmoni me kushtetutën dhe ligjet në fuqi të secilit shtet. Pavarësia e funksionimit të vetëqeverisjes lokale dhe organeve të saj është e garantuar me kushtetutë.

Kjo pavarësi qëndron në:

1. të drejtën e qytetarëve që drejtpërdrejt, ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në organet përfaqësuese, të ushtrojnë funksion vetëqeverisës;
2. pavarësinë organizative të institucioneve lokale;
3. ekzistimin e funksionit të pavarur të përcaktuar me kushtetutë për kryerjen e punëve me interes të përgjithshëm lokal, pa ndërhyrjen e organeve të pushtetit qendror;
4. ekzistimin e mjeteve financiare dhe të mjeteve të tjera të njësive lokale të pavarura; 41
5. ekzistimin e administratës së pavarur, pa ndërhyrjen e organeve qendrore, në kuadër të kushtetutës dhe ligjeve, në harmoni me Kartën evropiane të vetëqeverisjes lokale; dhe,
6. ekzistimin e normave të vetëqeverisjes lokale dhe mbrojtjes kushtetuese të tyre.

Por vetëqeverisja lokale ka edhe karakteristika të veçanta që varen nga rregullimi shoqëror dhe politik i secilit shtet. Në disa shtete, krahas organeve të vetëqeverisjes lokale, ka institucione dhe organe të administratës, që ushtrojnë edhe funksione të organeve qendrore. Në shumicën e shteteve, njësive të vetëqeverisjes lokale u jepen kompetenca nga autoriteti qendror apo rajonal, varësisht nga nivelet e organizimit shtetëror. Në raste të tilla, ato janë kompetenca të deleguara, që përcillen me mbështetje financiare dhe profesionale për jetësimin praktik të tyre. Duke marrë për bazë veçoritë e organizimit të sistemit të ²⁷vetëqeverisjes lokale, llojet dhe

²⁷ VETËQËVËRISJA LOKALE, MODELET, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI - RASTI I KOSOVËS Ramiz Fazliu

nivelin e organizimit të njësive të vetëqeverisjes lokale, përkufizimet dhe sanksionimin kushtetues të tyre.

Në grupin e dytë të të ardhurave, bëjnë pjesë mjetet plotësuese nga buxheti i Republikës si dhe të ardhurat në formë të huasë nga buxheti i republikës, që të mos ndërpritet funksionimi i njësive të vetëqeverisjes lokale.

Përpjekjet e njerëzve çdo herë janë ato në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të tyre, sa më shpejt, sa më afër, t'i kryejnë problemet e jetës së përditshme. Kjo çështje kaq e rëndësishme parashihet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë²⁸, si dhe ligji mbi vetëqeverisjen lokale.²⁹

Format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve për zgjidhjet e çështjeve me karakter lokal janë: tubimi i qytetarëve, iniciativa e qytetarëve dhe Referendumi.

Për të siguruar një shpërndarje më të mirë të pushtetit mes komuniteteve të ndryshme lokale që jetojnë në Maqedoni, Marrëveshja e Ohrit bëri thirrje për një reformë të decentralizimit të pushtetit.

Kjo reformë, e mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe aktorët kryesorë ndërkombëtarë në Maqedoni, ka rezultuar në ndryshime të mëdha legjislative në vitin 2004. Territori i Maqedonisë është i ndarë tani në 84 komuna (plus Qyteti i Shkupit, i përbërë nga 10 komuna).

Këto komuna kanë më shumë pushtet se më parë në marrjen e vendimeve dhe buxheteve të menaxhimit. Komunat kanë një fuqi të vendim-marrjes lidhur me atë ekonomik lokal, mbrojtjen mjedisore të zhvillimit dhe natyrën, kulturën, planifikimin urban, sport, mirëqenien sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve, dhe të arsimit. Realizimi praktik i këtij procesi të decentralizimit është ende në vazhdim. Transferimi i aftësive të takohet me disa probleme për shkak të kompleksitetit të procesit, por edhe me gjendjen e tranzicionit politik dhe ekonomik që po përballet Maqedonia.

Ky parim nënkupton që votimi në fjalë duhet të mbajë një shumicë votash të dy grupeve: atë të të gjithë këshilltarëve, në mesin e atyre këshilltarëve që përfaqësojnë komunitetet e pakicave etnike në komunë.

Dispozitat e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit 13 gusht 2001, Marrëveshja Kornizë e Ohrit ka imponuar reforma të rëndësishme që më mirë të përfaqësojë minoritetet duke iu siguruar një kushtetutë të re. Sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje, 1991 Kushtetuta është ndryshuar për të fshirë referencën

²⁸Po aty, Neni 115

²⁹Ligji i vetëqeverisjes lokale i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 1995(Gazeta Zyrtare ne RMV), Nenet 20-23.

që sllavët maqedonas janë populli i vetëm themelues të vendit. Shoqëria „maqedonas” shihet tashmë si shoqëri e përbërë nga qytetarë të grupeve të ndryshme etnike.

Marrëveshja përcakton një sistem të "shumicës së dyfishtë" në Parlament, i cili siguron që, për t'u miratuar, një tekst duhet të plotësojnë së paku gjysmën e votave të një apo formacioneve të ndryshme që përfaqësojnë pakicat etnike.

Përdorimi i shqipes është i autorizuar për dokumentet zyrtare dhe si gjuhë pune në seancat plenare dhe komisioneve parlamentare, si dhe në gjykatë. Të gjitha ligjet janë të shkruara në dy gjuhë, maqedonase dhe shqiptare. Megjithatë, vetëm maqedonas mund të përdoret nga qeveria maqedonase (përveç në zona të caktuara shqiptare). Shqipja është gjuha e dytë zyrtare në zonat ku shqiptarët përbëjnë mbi 20 për qind të popullsisë. Shteti merr përsipër të financojë, përveç arsimit fillor dhe të mesëm, arsimin e lartë (Universitetin) në gjuhën shqipe në zonat ku shqiptarët përbëjnë së paku 20% të popullsisë.

Tani, shteti garanton përfaqësimin proporcional të pakicave në Publik dhe të Policisë dhe Gjykatën Kushtetuese. Një proces i decentralizimit është planifikuar. Së fundi, shteti i jep status të barabartë me ortodoks, katolikë dhe myslimanë.

Tani, shteti garanton përfaqësimin proporcional të pakicave në Publik dhe të Policisë dhe Gjykatën Kushtetuese. Një proces i decentralizimit është planifikuar. Së fundi, shteti i jep status të barabartë mes ortodoksëve, katolikëve dhe myslimanëve. Organizimi territorial i Maqedonisë³⁰ Maqedonia është e ndarë në 84 komuna (opštini, njëjës opština), të ndarë në tetë Rajone (Regjione) që nuk kanë asnjë rol administrativ.

Zgjedhjet janë të përgjithshme, të drejtpërdrejta, të lira me votim të fshehtë në të cilat zgjidhen anëtarët e këshillave të komunës, dhe kryetarët e komunave. Zgjedhjet lokale bëjnë pjesë në karakteristikat themelore të parimeve demokratike të vetëqeverisjes lokale, e cila rregullohet me ligj të vecantë në shtetet, që dëshirojnë të ndërtohen mbi parimet demokratike.

Në Republikën e Maqedonisë, ligji parasheh dy principe kryesore të zgjedhjes dhe atë:

- Modeli proporcional
- Modeli i shumicës

Në princip të parë zgjidhen anëtarët e këshillit me ç'rast votohet për listën e kandidatëve të anëtarëve të këshillit në komuna.

³⁰ Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. www.mls.org.mk Asociacioni i Komunave të Maqedonisë (ZELS)- www.zels.org.mk Qendra për Zhvillimin Rajonal. www.brr.gov.mk

Në principit të dytë, zgjidhet Kryetari i Komunës.

Të drejtë votimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë, që kanë mbushur moshën 18 vjeçare, kanë zotësi për të vepruar, dhe vendqëndrim të përhershëm në komunë.

Kodi zgjethore, garantohet liria dhe fshehtësia e votimit³¹, rregullohet inkopatibiliteti i funksionit të anëtarit të këshillit komunal dhe kryetarit të komunës me funksionet tjera publike.

Përcaktimi i afateve dhe procesi i zgjedhjeve për mbajtjen e zgjedhjeve dhe caktimin e ditës i parasheh ligji, ndërsa shpalljen e zgjedhjeve e bën Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë.

Organet për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve lokale janë:

Komisionet zgjedhore të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe Këshillat zgjedhore.

Komisionet zgjedhore i emëron Komisioni shtetëror i zgjedhjeve me kohëzgjatje prej 4 vjetësh.

Komisionet zgjedhore përbëhen prej kryetarit dhe katër anëtarëve, të cilët kanë zëvendësit e tyre si dhe sekretarin.

Partitë politike propozojnë kandidatë për komisione. Nëse ato nuk e bëjnë, atëherë ato i emëron Kryetari i Komisionit.

Këshillat zgjedhore i emëron komisioni zgjedhor, që përbëhet prej kryetarit dhe dy anëtarëve, të cilët kanë zëvendësit e tyre³².

Fushata parazgjedhore paraqet moment të rëndësishm për mbajtjen e zgjedhjeve lokale ku kemi dy nënfaza:

- Faza e propozimit të kandidatëve dhe
- Faza e kontaktit me bazën zgjedhore-tubimet, promovimet paraelektorale

Listat e kandidatëve i dërgohen komisionit zgjedhor më së voni 30 ditë para ditës së votimit.

Ajo listë duhet të jetë e nënshkruara nga personi i autorizuar i bartësve të listës të partisë politike ose nga grupi i zgjedhësve.

Fushata parazgjedhore fillon 30 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve dhe përfundon 48 orë përpara ditës së zgjedhjeve (kjo quhet heshtje zgjedhore)³³.

³¹ Ligji mbi zgjedhjet lokale, Shkup, 1996, Neni 4.

³² Po aty, Nenet 8-14.

³³ Po aty, Neni 26.

Komisioni zgjedhorë bën përzgjedhjen e vendvotimeve në vende të caktuara. Votimi bëhet në fletëvotime të veçanta për anëtarë të Këshillit Komunal dhe fletëvotimit për Kryetarin e Komunës.

Pas votimit, bëhet numërimi dhe verifikimi i rezultateve të zgjedhjes. Këtë e bën komisioni zgjedhor në bazë të modelit të Dontit.

Për kryetar komune zgjidhet kandidati që ka numër më të madh votash. Në qoftë se asnjë kandidat nuk ka fituar me shumicë absolute, atëherë shkohet në raundin e dytë, edhe në raundin e dytë për kryetar zgjidhet kandidati që ka më shumë vota.

Ligji parasheh edhe shkaqet për përsëritjen e zgjedhjeve.

Shkaqet për përsëritjen e zgjedhjeve janë: nëse gjatë numërimit ,në kutinë votuese ka më shumë fletëvotime se numri i votuesve që kanë dalur në votime; nëse është prishur fshehtësia e votimit; prezencës së organeve të punëve të mbrendshme; nëse ndërpritet votimi më shumë se tri orë, nëse procesverbali dhe materiali nuk dorëzohen më së voni deri më pesë orë, nëse votohet pa dokument identifikimi.

Nëse dëmtohen të drejtat e kandidatëve, ku gjatë kohës së mbajtjes së zgjedhjeve ka shkelje, atëherë ato kanë të drejtë të ngrenë procedurë për mbrojtjen e të drejtave të tyre pranë organit kompetent.

Gjykata vendos brenda tri ditësh dhe menjëherë e shpall në mjetet e informimit.

Për shkak të parregullsive, çdo kandidat ka të drejtë të bëjë kundërshtim drejtuar komisionit zgjedhor në afat prej 24 orësh³⁴, prej ditës kur është bërë parregullsia, ndërsa kundërshtimi për shkak të procedurës së zgjedhjeve bëhet në afat prej 48 orësh pas ditës së zgjedhjeve.

Komisioni duhet ta sjellë vendimin mbrenda 48 orëve. Për mbrojtje të së drejtës zgjedhore parashihet edhe e drejta e ankesës kundër vendimit të komisionit zgjedhor. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelaconit në afat prej 48 orësh.³⁵

Republikën e Maqedonisë deri në vitin 1996 kishte 34 komuna, ndarje e cila u trashëguara nga ish Republika Socialiste e Maqedonisë. Komunitat ishin mjaft të centralizuara, kështu që ndihej nevoja e një ndarjeje të re territoriale. Ndarja teritoriale është një nga karakteristikat themelore të vetëqeverisjes lokale dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale.

Faktorë të rëndësishëm janë: sipërfaqja e territorit, numri i popullatës, kufijtë e interesit lokal, lloji dhe volumi i profesioneve, homogjeniteti, gravitimi kah institucionet më të

³⁴ Po aty, Neni 68.

³⁵ Ligji mbi zgjedhjet lokale, Shkup, 1996, Neni 69.

rëndësishme të qeverisjes lokale. Përveç kësaj paraprakisht duhet të konsultohet popullata lokale, gjë që parashihet edhe në Konventën Evropiane për vetëqeverisje lokale.³⁶

Marrja parasysh e mendimit të vetëqeverisjes lokale nga ana e parlamentit të Republikës të Maqedonisë para nxjerrjes së ligjeve që u përkasin njësive të vetëqeverisjes lokale³⁷, parasheh mundësinë e participimit të njësive të vetëqeverisjes lokale në procesin ligjdhënës të parlamentit të Maqedonisë. Me Ligjin mbi ndarjen territoriale të vitit 1996, Maqedonia ka 123 njësi të vetëqeverisjes lokale (komuna) dhe Qytetin e Shkupit si njësi të veçantë.

Me këte ligj nuk janë marrë parasysh faktorët e lartpërmendur, prandaj edhe kjo ndarje nuk u tregua si e suksesshme për çka edhe pasuan ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi ndarjen territoriale të vitit 2004.

Në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 1997 parlamenti i Maqedonisë ka sjellur vendim për vetëqeverisje lokale dhe respektimin e të gjithë ligjeve që kanë të bëjnë me Konventen Evropiane.

Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjen territoriale në vitin 2004, Republika e Maqedonisë përbëhet prej 84 njësi të vetëqeverisjes lokale, dhe qytetin e Shkupit si njësi e vecantë.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit u pa si alternativë për të vendosur raporte të reja midis dy popujve dhe si një garanci se të dyja palët përkushtohen për një ardhmëri të qëndrueshme të Maqedonisë dhe inkuadrimit të saj në strukturat evro-atlantike.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit përbëhet nga tri anekse:

- Aneksi A -amandamentet kushtetuese
- Aneksi B - ndryshimet në legjislacion
- Aneksi C- implementimi dhe masat e ndërtimit të besimit.

Si ‘një pikënsje e zhvillimit të qetë dhe harmonik të shoqërisë qytetare, duke rrespektuar njëkohësisht identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë, duhet të respektohen disa parime;

Parimet themelore të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit janë:

- Hudhja poshtë e përdorimit të dhunës;
- Ruajtja e sovranitetit territorial dhe karakterit unitar të R.M –së.;
- Ruajtja e karakterit shumëtnik të shoqërisë maqedonase në jetën publike;

³⁶ Konventën Evropiane për vetëqeverisje lokale, 1985, Strasburg, Neni 5

³⁷ Po aty,1996, Neni 87

- Karakteri qytetar i Kushtetutës, në pajtim me standarde më të larta ndërkombëtare.

Hapi i parë që parashihej, ishte ndryshimi i Kushtetutës³⁸, dhe atë ndryshimi i pjesës hyrëse të Kushtetutës me të cilën pretendohet të ndryshohej karakteri i saj nga ai nacional në atë multietnik. Sa i përket vetëqeverisjes lokale në amandamentin e XVI-të se vetëqeverisja lokale rregullohet me ligj i cili nxirret me shumicën e votave, prej 2/3 të numrit të përgjithshëm të deputetëve dhe shumicën e votave të deputetëve që deklarohen se i takojnë bashkësisë jomaqedonase, ndërsa ligji për financimin lokal, ligji për zgjedhjet lokale, Ligji për ndarjen territoriale, nxirren me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm, të cilët u takojnë nacionaliteteve, që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Me amandamentin e XVII-të të ndryshimeve kushtetuese, parashihej decentralizimi i organeve të pushtetit qendror³⁹. Theksohej se duhet të miratohet sa më shpejt Ligji i reviduar i vetëqeverisjes lokale me të cilin do të forcohen autorizimet e përfaqësuesve të zgjedhur vendorë dhe dukshëm do të rriten kompetencat e tyre në përputhje me Kushtetutën (ndryshimet e parashikuara me Aneksin A) dhe, me ç'rast shprehet parimi i organizmit vertikal i cili është në fuqi në Bashkimin Evropian.

Pikën e dytë theksohej afati i regjistrimit të ri të popullatës në mbikqyrjen ndërkombëtare, si dhe për revidimin e kufijve komunalë nga autoritetet lokale dhe nacionale me pjesëmarrjen ndërkombëtare.

Pikën e tretë të theksohej mënyra e zgjedhjes së kryeshefit lokal të policisë. Parashihej që kryeshefin ta zgjedhin këshilltarët e komunave nga lista e kandidatëve të propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe të njëjtit do të komunikojnë me këshillat, kurse Ministria e Punëve të Brendshme do ta mbajë autorizimin për shkarkimin e kryeshefave lokalë të policisë, në pajtim me ligjin.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit e obligonte Parlamentin që, deri në fund të mandatit, ta miratojë ligjin për financimin e njësisve të vetëqeverisjes lokale, ndërsa me ligjin mbi ndarjen territoriale dhe caktimin e kufijve të vetëqeverisjes lokale deri në fund të vitit 2002, sikurse dhe ligjin për nëpunësit shtetërorë dhe ligjin që ka të bëjë me përdorimin e gjuhëve zyrtare. Me marrëveshjen Kornizë të Ohrit parashihej edhe mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë i të gjithë personave para ligjit.

Me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit parashihej nxjerrja, ndryshimi dhe plotësimi i disa ligjeve, të ashtuquajtura "paket-ligjeve" të decentralizimit të disa fushave, që kanë të bëjnë me

³⁸ Agni Aliu & Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Njoftim themelor dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë, Prishtinë, 2009, faqe 118

³⁹ Po aty, faqe 118-119

vetëqeverisjen lokale siç janë: revidimi i Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale⁴⁰, Ligji mbi ndarjen territoriale, Ligji mbi financimin e vetëqeverisjes lokale, Ligji mbi zgjedhjet lokale, Ligji mbi arsimin, Ligji mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare etj.

Kërkohej që këto ligje të harmonizoheshin me konventat ndërkombëtare për arsye se Republika e Maqedonisë jo vetëm që është nënshkruese e një numri të madh të konventave ndërkombëtare, por ajo është pretendente serioze për antarësimin e saj në NATO dhe integrimin e saj në Bashkimin Evropian. Ashtu që organeve të pushtetit lokal t'u mundësohej pavarësia e ushtrimit të punëve të tyre me qëllim që ato të ishin më efikase në shërbimet ndaj qytetarëve të tyre, duheshin të sjellin një sërë ligjesh që tu mundësohej bartja e kompetencave nga organet e pushtetit qendror në organet e pushtetit lokal.

Decentralizimi është një proces, i cili në vete përfshin transferimin, bartjen e kompetencave nga organet e pushtetit qendror në organet më të ulëta, i cili bën demokratizimin e vazhdueshëm të shoqërisë. Ai mënjanon rrezikun e kthimit prapa drejt një shteti të centralizuar dhe burokratik, kështu që Maqedonia nëse dëshiron që ta ndjek rrugën drejt strukturave Evro-Atlantike duhet që patjetër të vazhdojë reformat edhe më tutje.

Që tu mundësohet qarkullimi i lirë i mallrave dhe shërbimeve, si dhe lëvizja e lirë e personave në territor sa më të madhë ju duhet integrimi në këto struktura.

⁴⁰ Po aty, faqe 120-121

1.4 Karakteristikat themelore te Vetëqeverisjes Lokale

Vetëqeverisja Lokale që nga lindja dhe gjatë zhvillimit të saj vetëqeverisja lokale paraqitet si disiplinë shkencore me shumë tipare të veçanta.

Lindja e vetëqeverisjes lokale ndërlidhet me dukuritë e para të saj, pavarësisht se ajo si disiplinë shkencore paraqitet shumë më vonë, kur merr tiparet e një discipline të pavarur nga disiplinat e tjera shkencore, në kuadër të së cilave studiohej më parë dhe nga të cilat u shkëput në kushte dhe rrethana të reja të zhvillimit dhe të diferencimit të shkencës. Filimisht ajo u studiu në kuadër të shkencave politike dhe të shkencave juridike.⁴¹

Secila disiplinë shkencore si dhe çdo dukuri a fenomen shoqëror, kushtëzohet, në parim, me lindjen dhe zhvillimin e vet nga rrethana të caktuara shoqërore. Kur bëhet fjalë për disa parakushte që duhet të përmbushen bëhet fjalë për lindjen e shkencave shoqërore.

Nuk ka dyshim se parakusht themelor i lindjes së një discipline shkencore është vetë paraqitja e substratit të dukurisë shoqërore të caktuar të cilin, në fakt, ajo disiplinë shkencore, e studion.

Bie fjala para lindjes të së drejtës nuk ka pasur mundësi që të lind shkenca juridike përgjithësisht. Njëjtë është dhe me vetëqeverisjen lokale. Para shfaqjes së institucioneve të vetëqeverisjes lokale dhe lindjes dhe krijimit të marrëdhënieve në to nuk ka pasur mundësi për emancipimin e plotë të kësaj discipline shkencore. Vetëqeverisja lokale ka mundur të shfaqet si disiplinë e veçantë shkencore vetëm atëherë kur substrati i saj shkencor ka arritur shkallë të caktuar të zhvillimit në shoqëri.

Parakushte të tjera që janë me rëndësi për lindjen dhe zhvillimin e një discipline të veçantë shkencore. Ndër ato parakushte rol të madh ka luajtur ndarja shoqërore e punës. Dihet se në fillimet e shkencës përgjithësisht, të gjitha shkencat pothuajse ishin një dhe me to merreshin të njëjtit njerëz. Zhvillimi i shkencave në vartësi prej zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore ndikoi në diferencimet e para të studimit të fenomeneve shoqërore dhe për pasojë specializimin e njerëzve për studimin e dukurive të caktuara dhe të fushave të caktuara të cilave u përkisnin ato dukuri.

Natyrisht si ndër elementet e tjera kanë pasur ndikim dhe instrumentet e studimit të dukurive shoqërore, po sikurse dhe teknika e kërkimeve a hulumtimeve që janë zhvilluar dhe përsosur vazhdimisht.

⁴¹ Agni Aliu & Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Njoftim themelor dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë, Prishtinë, 2009, faqe 43

Më në fund zhvillimi i një disipline shkencore është varur dhe nga rëndësia shoqërore që ka pasur ajo varësisht nga aktualiteti i problematikës me të cilën është marrë dhe peshën që ka krijuar ajo për një bashkësi shoqërore të organizuar në kohë dhe në hapësirë të caktuar.

Mbi lindjen e vërtetë të vetëqeverisjes lokale si disiplinë më vete shkencore mund të bëhet fjalë vetëm atëherë kur në vendet e caktuara të botës shfaqen përpjekjet e ndërtimit të sistemit të veçantë të normave që rregullonin vetëqeverisjen lokale dhe përmasat e shprehjes së saj.

Që në fillim u vërejt nevoja që vetëqeverisja lokale të trajtohet ndaras prej dukurive tjera shoqërore dhe politike, edhe pse një kohë relativisht të gjatë të historisë së lindjes dhe zhvillimit të saj pati lëkundje në kuadër të cilave disiplina shoqërore përgjithësisht, juridike a politike veçanërisht duhet të vendoset objekti i veçantë i studimit të qeverisjes lokale.⁴²

Marrë në përgjithësi objekt të qeverisjes lokale paraqesin normat ligjore dhe të tjera me të cilat rregullohet vetëqeverisja lokale në të gjitha përmasat e shprehjes së saj.

Përkufizimin e qartë të objektit të vetëqeverisjes lokale e vështirëson fakti se segmente të qeverisjes lokale studiohen dhe nga disiplina të tjera shkencore shoqërore qofshin ato politike ose juridike.

Objekt i vetëqeverisjes lokale janë marrëdhëniet që lindin e krijohen në fushën e vetëqeverisjes lokale përgjithësisht dhe dukuritë me të cilat shpërfaqen ato marrëdhënie të vështuara kryesisht në aspektin ligjor, mbi bazën e infrastrukturës juridike që i referojë kësaj lënde studimi duke u nisur nga parimet e vetëqeverisjes lokale që paraqitet si një "magna carta" për të gjitha sistemet e vetëqeverisjes lokale në Evropë.

Në objektin e vetëqeverisjes lokale përfshihen statusi ligjor i komunave si njësi boshtore të vetëqeverisjes lokale, organizimi dhe funksionimi i organeve komunale, marrëdhëniet brendakomunale dhe bashkëpunimi ndërkomunal, marrëdhëniet me pushtetin qendror, parimet e përgjithshme të financimit të komunave dhe çështje të tjera të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë shtrihen në fushën e vetëqeverisjes lokale.

Për shkak të shumëanshmërisë dhe shumëllojshmërisë së tyre, kompetencat e organeve komunale përbëjnë një fushë të veçantë të shtrirjes së objektit të vetëqeverisjes lokale ku prej kompetencave vetanake që do të thotë prej autorizimeve që komunat i marrin nga kushtetuta dhe ligji dhe për të cilat autorizime bartin përgjegjësinë e plotë, nëpërmjet kompetencave në institucionet lokale nga qeveria qendrore dhe deri te kompetencat e zgjeruara që shprehin autorizime shtesë që u jepen komunave në bazë të ligjit.

⁴² Po aty, faqe 43-44

Me gjithë përpjekjet për ta përkufizuar në mënyrë sa më të plotë dhe më të qartë, objekti i vetëqeverisjes lokale, i paraqitur si më lartë, duhet t'i nënshtrohet një gjykimi dhe vlerësimi kritik, duke pasur parasysh dhe përvojat e krijuara në sistemet e ndryshme të vetëqeverisjes lokale për të marrë një vlerë krahasimtare. Vështrimi krahasimtar mund të ndihmojë që institucionet e veçanta të vetëqeverisjes lokale të shpërfaqen në dimension më të plotë dhe më të kuptueshëm nga këndi i nevojave të përgjithësimit të dukurive të vetëqeverisjes lokale dhe i nxjerrjes së përfundimeve më të qendrueshme në lidhje me to.

Duke pasur parasysh origjinën shumë të hershme të tyre mbetet hapur çështja se a do të duhej që objekti i vetëqeverisjes lokale të shtrihet dhe të zgjerohet dhe në institucione të vetëqeverisjes lokale. Sidoqoftë po bëhen kërkime dhe hulumtime që mund t'i ndihmojnë një përkufizimi më të plotë dhe më të qartë të objektit të vetëqeverisjes lokale si disiplinë e veçantë shkencore, e para dhe e trajtuar e ndarë dhe e shkoqur prej disiplinave të tjera të shkencave shoqërore, vecanërisht prej atyre politike dhe juridike.⁴³

Vetëqeverisja lokale me një numër të specifikave të veta e rrethuar me një numër të konsiderueshëm normash juridike që i rregullojnë institucionet e përgjithshme të saj dhe marrëdhëniet që lindin dhe krijohen në to krijon hapësirë dhe mundësi që të vështrohet ndaras prej disiplinave të tjera të shkencave shoqërore. Mirëpo, nga ana tjetër lidhshmëria e marrëdhënieve që lindin e krijohen në institucionet e vetëqeverisjes lokale me marrëdhëniet që studiohen nga disiplina të tjera të shkencave shoqërore i bën ato në masë të ndërvarura prej tyre ose së paku të krahasueshme me to. Si u tha dhe me një rast tjetër qeverisja lokale nuk studiohet vetëm dhe kryesisht prej lëndës që mban atë emërtim ose një emërtim tjetër të ngjashëm me të por dhe nga disiplina të tjera të shkencave shoqërore për shkak të shumëanshmërisë dhe shumëllojshmërisë së përmasave në të cilat ato paraqiten në praktikë jo vetëm në kuadër të vendeve të ndryshme, por edhe brenda përbrenda një vendi të vetëm në kuadër të një discipline të vetme. Ky fakt e bën më të vështirësuar vështrimin e raportit të vetëqeverisjes lokale ndaj disiplinave të tjera shkencore një problem që shfaqet dhe me disiplinat e tjera përgjithësisht. Megjithatë përballimit të këtij problemi duhet qasur me përpjekjet së paku teorike për karakterin e veçantë të dukurive dhe marrëdhënieve që studiohen në kuadër të vetëqeverisjes lokale që ndryshe krijojnë dhe mundësinë që ajo të ketë objektin e veçantë të studimit, të ndryshëm prej disiplinave të tjera shkencore. Nga ana tjetër nuk duhet lënë anash dhe kryqëzimet dhe ndikimet e ndërsjellta të atyre dukurive dhe marrëdhënieve me dukuritë dhe marrëdhëniet që studiohen prej disiplinave të tjera shkencore. Shih për këtë raportin e vetëqeverisjes lokale ndaj disiplinave të tjera shkencore duhet vështruar nga dy kënde: njëri nga pikat takuese që ka vetëqeverisja lokale me disiplinat e tjera të shkencave shoqërore, ndërsa tjetri, nga pikat ndarëse që ka kjo lëndë studimore në raport me disiplinat e tjera të shkencave shoqërore.

⁴³ Po aty, faqe 45

Vetëqeverisja lokale është në raportin më të ngushtë me të drejtën kushtetuese dhe me sistemin politik, me vetë faktin se ajo, jo si lëndë mësimore, por si institucion, paraqitet edhe si kategori e rendit kushtetues, dhe si kategori e sistemit politik⁴⁴. Ky pohim është dëshmuar në literaturën e vetëqeverisjes lokale, por edhe në praktikën kushtetuese të shumë vendeve të Evropës në të cilat, qeverisja lokale është trajtuar në parim në aktet më të larta juridike të atyre vendeve, ndërsa nga ana tjetër, është konsideruar si institucion i rëndësishëm politik. Në lidhje me vërejtjen e parë praktikët janë të ndryshme sepse një numër shtetesh e kanë rregulluar vetëqeverisjen lokale në parim me aktin kushtetues, ndërsa një numër tjetër shtetesh e kanë bërë këtë me ligj. Në të dyja rastet nuk mohohet të qenit e vetëqeverisjes lokale kategori kushtetuese. Në lidhje me vërejtjen e dytë ngjashmëritë dhe praktikët janë më të përafërta, sepse dominojnë përvojat e vendeve të Evropës në të cilat vetëqeverisja lokale përveç se ka marrë dhe cilësime të tjera, është karakterizuar dhe si institucion i sistemit politik të vendit të caktuar.

Vetëqeverisja lokale dhe e drejta kushtetuese kanë pika të përbashkëta, në pjesë që e drejta kushtetuese i referohet qeverisjes lokale. Në të vërtetë me normat e së drejtës kushtetuese së paku në parim rregullohen institucionet e vetëqeverisjes lokale dhe marrëdhëniet që lindin dhe krijohen në to. Mirëpo, studimi i institucioneve të vetëqeverisjes lokale dhe i marrëdhënieve që lindin e krijohen në to është më shumë parimor se sa i detajuar. Studimi i detajuar i institucioneve të vetëqeverisjes lokale i takon vetëqeverisjes lokale që si lëndë mësimore është parashikuar në shumë fakultete e drejtime, në rradhë të parë të shkencave juridike dhe politike, por edhe në shkenca të tjera shoqërore, pavarësisht shkallës më të ulët të interesimit shkencor për vetëqeverisjen lokale në ato disiplina.

Njëjtë është edhe me raportin e vetëqeverisjes lokale me lëndën e sistemit politik që, poashtu, si lëndë mësimore studihet kryesisht në fakultetet e administrimit publik, fakultetet juridike dhe fakultetet e shkencave politike, por edhe në ndonjë fakultet dhe drejtim tjetër.

Sikurse në shqyrtimet për pikat takuese dhe ndarëse midis dy disiplinave të ngjashme, por të ndryshme, në parim merren dy kritere në bazë të të cilave kërkohen pikat dalluese midis tyre. Së pari, objekti i studimit që është i ndryshëm, me gjithë elementet e përbashkëta, dhe së dyti, metoda e studimit që, gjithashtu, është e ndryshme për ato disiplina shkencore.

Vetëqeverisja lokale nuk ka dyshim se sistemi politik në parim merret dhe me studimin e institucioneve dhe të dukurive që shfaqen dhe zhvillohen në fusha të ndryshme, por sistemi politik si një lëndë që shtrihet në të gjitha institucionet e sistemit, vetëqeverisjen lokale e studion fragmentarisht ose në vija të përgjithshme, ndryshe nga vetëqeverisja lokale që i qaset në mënyrë më të plotë dhe më të tërësishme.

Ndërsa sa i përket metodës së studimit, për studimin e vetëqeverisjes lokale, për shkak të specifikave që ka, përveç metodave të përgjithshme që përdoren për studimin e sistemit politik,

⁴⁴ Po aty, faqe 46

përdoren edhe metoda të veçanta nëpërmjet të cilave përmbushen kërkesat për qasje të veçantë ndaj institucioneve të vetëqeverisjes lokale dhe marrëdhënieve që lindin e krijohen në to.

Vetëqeverisja lokale si një disiplinë e veçantë fillimisht tërheq vërejtjen për dallimin midis objektit dhe lëndës së një shkence të caktuar.

Objekt i vetëqeverisjes lokale është studim i ligjshmërive të dukurive në lidhje me institucionet e vetëqeverisjes lokale dhe marrëdhëniet që lindin dhe krijohen në to, ndërsa lëndë e studimit të vetëqeverisjes lokale janë vetë institucionet e vetëqeverisjes lokale.⁴⁵

Institucionet e vetëqeverisjes lokale mund të paraqesin pjesë të lëndës për disiplina të ndryshme shoqërore (si e drejta, shkencë politike e tjera).

Siç dihet janë disiplina të ndara shkencore nga shkencë e vetëqeverisjes lokale, e cila ka për objekt specifik shqyrtimin e dukurive shoqërore lidhur me institucionet e vetëqeverisjes lokale me qëllim të përcaktimit të ligjshmërive empirike në ato dukuri, ligjshmërive të cilat janë karakteristike për fushën e vetëqeverisjes lokale në përgjithësi.

Burimet për studimin e vetëqeverisjes lokale janë të shumëduarshme.

Lindja dhe zhvillimi i tyre kushtëzohet nga karakteri i marrëdhënieve që studiohen në vetëqeverisjen lokale. Burime të veçanta përbëjnë dhe format e shpërfaqjes së atyre marrëdhënieve në akte të ndryshme me të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, rregullohen vetë ato marrëdhënie.⁴⁶

Të gjitha institucionet e vetëqeverisjes lokale përbëjnë një sistem të veçantë të vetëqeverisjes në kuadër të një makrosistemi të vetëqeverisjes.

Sikurse çdo disiplinë shkencore që ka sistem studimi që, si rregull, kushtëzohet nga karakteri i dukurive dhe marrëdhënieve që studiohen në të, edhe vetëqeverisja lokale ka një sistem të studimit, por më shumë elemente të përbashkëta me sistemet e disiplinave të tjera shkencore.

. Sistemi i vetëqeverisjes lokale përkon me vetë përmbajtjen e lëndës që studiohet në të dhe mënyrën e metodën e studimit të saj.

⁴⁵ Agni Aliu & Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Njoftim themelor dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë, Prishtinë, 2009, faqe 47-48

⁴⁶ Agni Aliu & Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Njoftim themelor dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë, Prishtinë, 2009, faqe 48

Kapitulli i Dytë

Themelimi, Territori, Simbolet, Organet e Komunës së Gostivarit

Themelimi

Komuna e Gostivarit është e themeluar dhe rajoni i saj është përcaktuar me Ligjin për organizimin territorial të vetvendosjes vendore në Republikën e Maqedonisë .

Themelimi i komunave bëhet mbi bazat e kompetencave ligjore dhe kushtetuese, të Republikës së Maqedonisë.

Komuna e Gostivarit është komunë që shtrihet në pjesën perëndimore të Maqedonisë duke u kufizuar me komunën e Vrapçishtit, Kërçovës, Tetovës, dhe Mavrovës.

Konformë kompetencave të Komunës , në pajtueshmëri me ligjin, përcaktohen:

- organizimi dhe puna e organeve të Komunës;
- organizimi dhe puna e komisioneve të Këshillit të Komunës;
- kryerja e punëve në pajtueshmëri me parimin e subsidiaritetit;
- mënyra e informimit të qytetarëve dhe qasje e lirë në informatat me karakter publik;
- rastet e përjashtimit të opinionit nga seancat e Këshillit të Komunës;
- mënyrën dhe procedurën për paraqitjen e parashtrësive dhe propozimeve për punën e organeve të komunës dhe veprimin sipas tyre;
- mënyrën e organizimit të tribunave publike, zbatimin e akteve dhe grumbullimin e propozimeve të qytetarëve;
- mënyrën e shpalljes së rregullave të Këshillit;
- mënyrën e kryerjes së obligimeve nga sfera e mbrojtjes në gjendje lufte;
- vetvendosjen vendore;
- mënyrën dhe procedurën për përcaktimin e stemës dhe flamurit të Komunës;
- çështje të tjera me rëndësi për Komunën.

Me statut dhe rregulloren që aprovon , Këshilli i Komunës vendos shumë çështje të caktuara lidhur me realizimin e kompetencave, procedurat e punës dhe vendosjen për së afërmi.

Po ashtu e nxjerr rregulloren , me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Komuna ka festën e saj. Festa e Komunës është 23 dhjetori –dita e konstituimit të Këshillit të parë pluralist të Komunës së Gostivarit⁴⁷.

Komuna ka stemën dhe flamurin. Stema e Komunës është paraqitur me kështjellë që e shpreh pasqyrën për lashtësinë e qytetit, në mes është vendosur „KULLA E SAHATIT,, me të cilën shprehet arkitektura burimore e qytetit, e në prapavijë është prezentuar lumi Vardar në formë të harkut që e shpreh rrjedhën e lumit, nga ana e majtë shtrihet Mali Sharr, e nga ana e djathtë shtrihet mali i Thatë me gërshtetim në të gjithë sipërfaqen e ngjyrës së bardhë të kaltërt të mbyllur dhe ngjyrë të kaltërt të hapur.

Flamuri i Komunës ka formë drejtëkëndëshi me ngjyrë të kaltërt të mbyllur, e në këndin e majtë të epërm ndodhet stema e Komunës me të gjitha elementet e lartëpërmendura për stemën.

Komuna ka vulë me formë rrethore me diametër 30 (tridhjetë) milimetër, në mesin e së cilës ndodhet stema e Komunës dhe në skajet e së cilës është shkruar me tekst në gjuhën Maqedonase dhe në gjuhën shqipe „Република Македонија - Општина Гостивар,, kurse nga gjysma e anës së djathtë të vulës :”Republika e Maqedonisë- Komuna e Gostivarit – Gostivar”

⁴⁷ STATUTII KOMUNËS SË GOSTIVARIT 2006 nenit 7 dhe 36 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02), Neni 1,2,3,4,5

Territori

Natyra mahnitëse, toka, pozita e volitshme gjeografike, mbi 500 m lartësi mbidetare, me gurgullimën e burimit të lumit Vardar, aty në perëndim të Maqedonisë, i rrethuar nga dy fortesa, Sharri dhe Mali i Thatë, dhe me shumë karakteristika të tjera, shtrihet i qetë me banorët e tij qyteti i shumë ngjarjeve dhe personaliteteve, GOSTIVARI.

Për të soditur për së afërmi panoramën e mrekullueshme të qytetit të Gostivarit goftë duke ardhur nga Tirana, në Ohër për në Gostivar, apo nga Prishtina, Shkupi, nga Tetova për në Gostivar, shfrytëzohen autostrada moderne që shkelin nëpër fushën e gjerë të Pollogut.

Përndryshe të gjitha komunikacionet, rrugore apo hekurudhore, mundësojnë qarkullim të shpejtë. Në njëqind kilometra në jug ndodhet aeroporti në Ohër dhe rreth nëntëdhjetë kilometra larg aeroporti në Shkup.


Gostivari është komunë e cila kap sipërfaqe prej rreth 650 kilometra katrorë. Qyteti paraqet mjedis administrativ, politik, kulturor dhe biznesor për më tepër se tetëdhjetë mijë banorë, prej të cilëve në vetë bërthamën e qytetit jetojnë rreth 36 mijë. Mjedis tipik multikulturor. Në të jetojnë shqiptarë, maqedonas, turq, romë e të tjerë. Qytet i cili paraqet me të vërtetë vend të bukur jetese, duke ofruar klimë të këndshme në të gjitha stinët e vitit, vendpozitë të mrekullueshme, komunikacion, kushte për biznes, shkollim... Mu për këtë arsye me vite përpara, qartë është shprehur ekspansioni i popullatës, edhe i zhvillimit ekonomik, kultivimit të veçorive dhe veçanërisht i kujdesit dhe krijimit të kushteve sa është e mundur më kualitative për jetesë.

Prej pranverës së vitit 2005 perspektivat janë edhe më të fuqishme, me decentralizimin në vijim me çka përkujdesjen në pjesën më të madhe të punëve publike e ka pushteti lokal, përndryshe rezultatet tashmë edhe shihen.

Demografia

Duke u bazur në regjistrimin e fudit të vitit 2001, popullata në Komunën e Gostivarit është rreth 81042 gjithsej, është një qytet multi-etnikë i përbërë kryesisht me më shumë banorë të nacionalitetit Shqiptar me një numër më të madhë rreth 54038 ose 66.70%, ku në rend të dytë hyn popullata Maqedonase me një numër rreth 15877 ose 19.60%, duke u ndjekur nga popuj të tjerë, Turq me 7991 ose 9.80%, Rom 2237 ose 3.80%, Serb 160 ose 0.19%, Boshnjakë 39 ose 0.04%, Vlleh 15 ose 0.01 dhe popull të tjerë 685 ose 0.84.

| Nacionaliteti | Numri | Përqindja |
|-----------------|-------|-----------|
| Shqipëtar | 54038 | 66.70% |
| Sllavo-Maqedonë | 15877 | 19.60% |
| Turq | 7991 | 9.80% |
| Romë | 2237 | 3.80% |
| Vllehë | 15 | 0.01% |
| Sërb | 160 | 0.19% |
| Boshnjakë | 39 | 0.04% |
| Të tjerë | 685 | 0.84% |
| Gjithësej | 81042 | 100% |



Simbolet



Stema e Komunës është paraqitur me kështjellë që e shpreh pasqyrën për lashtësinë e qytetit, në mes është vendosur „KULLA E SAHATIT“, me të cilën shprehet arkitektura burimore e qytetit, e në prapavijë është prezantuar lumi Vardar në formë të harkut që shpreh rrjedhën e lumit, nga ana e majtë shtrihet Mali Sharr, e nga ana e djathtë shtrihet mali i Thatë me gërshtetim të të gjithë sipërfaqes të ngjyrës së bardhë të kaltërt të mbyllur dhe ngjyrës së kaltërt të hapur.

Flamuri i Komunës ka formë drejtëkëndëshi me ngjyrë të kaltërt të mbyllur, e në këndin e majtë të epërm ndodhet stema e Komunës me të gjitha elementet e lartëpërmendura për stemën

Komuna ka vulë me formë rrethore me diametër 30 (tridhjetë) milimetër, në mesin e së cilës ndodhet stema e Komunës dhe në skajet e së cilës është shkruar me tekst në gjuhën Maqedonase dhe në gjuhën shqipe „Република Македонија - Општина Гостивар“, kurse nga gjysma e anës së djathtë të vulës : "Republika e Maqedonisë - Komuna e Gostivarit –Gostivar"⁴⁸

⁴⁸ Po aty, Neni,6,7,8,9

Komuna e Gostivarit

Bartja e fuksioneve publike që nga pas pavarimit nga ISTRJ në Komuna e Gostivarit përfaqësohet nga kryetar shqiptar, dmth qe nga periudha e vitit 1992, kryetar i parë është zgjedhur z.Enver Zenku, me mandat të plotë 4 vjeçar deri në vitin 1996. Në vitin 1996 ka qenë një garë tejet serioze ne mes të Kryetarit të atëhershëm z.Zenku dhe kunder kandidatit z.Rufi Osmani.

.Në këtë garë në mënyrë demokratike kryetar zgjidhet Rufi Osmani, ndërsa kryesues këshilli zgjidhet Refik Dauti, por fatkeqësisht ky mandat nuk zgjat më tepër se dy vite për arsye të protestave të 9 Korrikut ku bëhet edhe burgosja e Kryetarit të atëhershëm të Komunës. Në atë periudhë të vitit 1998 për kryetar në vend të Rufi Osmanit zgjidhet z.Jamin Nuredini ndërsa kryesues këshilli zgjidhet z.Zudi Xhelili ku të njejtit vazhdojnë në detyrë deri në vitin 2001.

Pas konfliktit të vitit 2001 në atë periudhe për kryetar Komune zgjidhet z.Xhemail Rexhepi ndërsa kryesues këshilli zgjidhet z. Alil Snopce, me mandat të plotë 4 vjeçar deri në vitin 2005. Pas mbarimit të mandatit të z.Rexhepi prej periudhës 2005 deri në 2009 për kryetar komune zgjidhet z.Nevzat Bejta ndërsa kryesues këshilli z.Muamer Sadiku,të cilët përfaqësonin partinë e formuar të pas luftës BDI-në (Bashkimin Demokratik per Integrim).

Në vitin 2009 ka qenë një ndër garat më serioze komunale një garë që gjatë kohë do te ngelet në mendjet e qytetarëve të Gostivarit, ka qenë ajo midis kryetarit të atëhershëm të zgjedhur z. Nevzat Bejta dhe z.Rufi Osmani i cili pas një periudhe të gjatë pauze në skenën politike përsëri i futet garës për të parin e Gostivarit ku del edhe fitues bashkë me bartësin e listës për kryesues të këshillit z.Fadil Zendeli.

Në periudhen 2009-2013 ne garë kemi një ballafaqim të njetë të kryetarëve edhe atë midis z.Bejta dhe z.Osmanit por atë rradhe fituese del partia e cila ishte në pushtet dhe për kryetar komune zgjidhet z.Nevzat Bejta dhe kryesues këshilli zgjidhet z.Nasir Musliu dhe po të njejt vazhdojnë deri në vitin 2017.

Në garat Komunale te vitit 2017 z.Nevzat Bejta sfidohet nga kundër kandidati i taborit opozitar z.Arben Taravari. Në garë fitues i zgjedhjeve del z.Taravari, por në keshillin komunal fituese del partia e BDI-së me kryesus këshilli z.Nasir Musliu i cili ka udhëhequr me këshillin e komunës për dy vite.

Kryetari i komunës së Gostivarit është përfaqësuesi i popullit te cilin e kanë votuar për një mandat 4 vjeçar dhe është organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

Kompetencat kryesore të kryetarit të Komunës së Gostivarit janë:

- Shpall aktet dhe vendimet e Këshillit komunal;
- I propozon Këshillit komunal sjelljen e vendimeve dhe akteve tjera nga kompetencat e tij;
- Menaxhon me organin drejtues dhe administrativ;
- I emëron dhe i shkarkon personat udhëheqës në Organin drejtues dhe administrativ;
- Emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit arkitektonik të qytetit.⁴⁹

Kryetari i komunës së Gostivar zgjidhet çdo të katërtin vit, në zgjedhje të përgjithshme të drejtëpërdrejta dhe të lira lokale me votim të fshehtë në pajtim me ligjin me të cilin rregullohet zgjedhjet lokale.

Obligimet e kryetarit të komunës:

- Kryetari i komunës së Gostivare përfaqëson dhe e prezenton komunën;
- Kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të Këshillit;
- Kryetari i shpall dispozitat e Këshillit në Fletoren zyrtare të Komunës;
- Kryetari i Komunës siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit;
- Siguron ekzekutimin e punëve në të cilat me ligj i janë deleguar Komunës;
- Inicion dhe e propozon sjelljen e rregulloreve në kompetencë e Këshillit;
- E propozon buxhetin vjetor dhe llogarinë vjetore të buxhetit të Komunës;
- E realizon buxhetin komunal;
- Kryetari i komunës e realizon procedurën për shpalljen e konkursit publik dhe bën zgjedhjen e drejtorit në shërbimet publike dhe institucionet komunale në përputhje me ligj;
- E informon këshillin për kryerjen e obligimeve nga kompetenca e vet në pajtim me statutin e komunës;
- Vendos për çështje administrative për të drejta, detyra dhe interesa të personave juridikë dhe fizik në pajtim me ligjin;
- Sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale;
- Udhëheq me administratën e komunës;
- Kryetari i komunës vendos për punësimin, të drejtat dhe obligimet si dhe përgjegjësitë e punonjësve në administratën komunale, në qoft se nuk është përcaktuar ndryshe me ligj;
- Kryetari i komunës administron dhe mbron pronën e komunës në pajtim me ligjin dhe statutin;
- Kryen edhe punët tjera të caktuara me Ligj dhe Statut.⁵⁰

⁴⁹ Po aty, neni, 48.

⁵⁰ Ligji për vetëqeverisje locale, neni 50.

Kryetari ka të drejtë të autorizoj nëpunës udhëheqës të komunës, të udhëheq procedurën dhe të vendos për punën administrative si dhe të nënshkruaj akte.

Kontrollimi i ligjshmërisë së regulloreve para publikimit të tyre:

Nëse Kryetari vleron se dispozita e Këshillit nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet, është i obliguar që në afat prej shatatë ditësh nga dita e sjelljes, me vendim të ndërpresë publikimin, ndërsa për këtë ndërprerje ti shpalos shkaqet.

Këshilli është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së vendimit që ta shqyrtojë vendimin dhe të vendos për të .

Në momentit që këshilli e verifikon dispozitën, kryetari i komunës është i obliguar që atë ta publikojë dhe njëkohësisht të ndërmerë iniciativë për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë për dispozitën kontestuese para Gjykatës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

Për iniciativën nga, Kryetari i komunës është i obliguar që ta informojë Ministrinë e Dikasterit për kryerje të punëve që i dedikohen administratës lokale.⁵¹

Kryerja e funksionit kryetar i komunës:

Kryetari i komunës i posazgjedhur e merr obligimin nga kryetari i mëparshëm në afat prej 7 ditësh nga dita e zgjedhjes;

Kryetari i komunës nga dita e pranimit e kryen në mënyrë profesionale funksionin e vet;

Kryetari me ushtrimin e funksionit mundet të kryej veprimtari tjetër profesionale;

Kryetari nuk mundet të thirret në përgjegjësi penale ose të paraburgoset për mendimin e dhënë në këshill;

Kryetari vendos se cili nga antarët e këshillit do ta zëvendësoj gjatë kohës në rastë të pengesave që ai të jetë në vendin e punës kur të mungojë, në pajtim me procedurën e caktuar në statut;

⁵¹ Ligji për vetëqeverisje lokale, neni 51.

Anëtarit të këshillit i pushon mandati në kohën kur e zëvendëson Kryetarin e komunës;

Kryetari i këshillit nuk mund ta zëvendësojë kryetarin e komunës;

Rroga dhe kompensimet e Kryetarit të komunës si dhe kompensimet e anëtarit të këshillit që e zëvendëson kryetarin e komunës rregullohen me ligj.⁵²

Konflikte të interesit të kryetarit të komunës:

Kryetari i komunës nuk mund të emërohet për anëtar në organe mbikqyrëse, drejtuese kontrolluese si dhe në shoqata tregtare dhe shkëmbime publike;

Kryetari i komunës nuk mund të merr pjesë në procesin e vendosjes për çështje që kanë të bëjnë me interesat financiare për bashkëshortin / bashkëshorten, fëmijën ose farefisën e shkallës së dytë në vijën anësore, ku ka interes tjetër personal apo financiar;

Kryetari është i obliguar ta informoj këshillin për interesin e qëndrimit;

Vendimin e sjell njëri nga anëtarët e këshillit i zgjedhur në mënyrë të njëjtë si është zgjedhur kryetari i këshillit;⁵³

Ndërprerja e mandatit të kryetarit të komunës:

Nëse vendos të jep dorëheqje;

Në rast vdekjeje;

Me akt gjykim të plotëfuqishëm nëse është i dënuar për veprë penale me dënim burgim në kohëzgjatje mbi 6 muaj;

Në qoftë se me vendim të plotëfuqishëm i hiqet aftësia punuese;

Nëse paraqitet rastë i mospajtit për kryerje të funksionit në pajtim me ligjin për zgjedhjet lokale;

Me mungesë pa arsye më gjatë se 6 muaj dhe në rast të ndërprerjes së banimit në atë komunë;

⁵² Po aty, neni 52.

⁵³ Po aty, neni 53.

Për arsyeshmërinë e mungesës, vendos këshilli me dy të tretat e votës nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit;

Anëtari i këshillit i cili e zëvendëson Kryetarin e komunës në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes një nga rastet për të kryer punë është i obliguar që për këtë punë të informoj ministrinë përkatëse që i referohet punëve të vet administratës lokale;

Ministria kompetente për kryerjen e punëve të cilat kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të zëvendësimit e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë e cila në afat prej një muaji nga dita e pranimit të njoftimit konstaton se është një nga rastet dhe njëkohësisht inicon procedura për shpalljen e zgjedhjeve të reja për kryetar komune, në pajtim me ligjin;

Në afat prej 30 ditësh këshilli nga dita e shpalljes së vendimit nga qeveria do të zgjedh një nga anëtarët e këshillit që do ta kryej funksionin e Kryetarit të komunës për periudhë deri te zgjedhja e Kryetarit të ri të Komunës, në mënyrë si zgjidhet Kryetari i Komunës;

Anëtarit të këshillit i pushon funksioni i mandatit „anëtar i këshillit,, në kohë të kryerjes së detyrës Kryetar komune në pajtim me procedurat ligjore;

Zgjedhjet nuk do të zbatohen nëse deri te periudha e re zgjedhore ka më pak se 6 muaj;⁵⁴

Aktet e Kryetarit të komunës për zgjedhjen e të drejtave individuale ,obligimeve dhe interesave të personave fizik dhe juridikë, Kryetari i Komunës sjell aktvendime.⁵⁵

Këshilli i Komunës Gostivarit

Këshilli i komunës është organ që përfaqëson qytetarët. Këshillin e komunës së Gostivarit e përbëjnë 31 këshilltarë, të zgjedhur nga qytetarët në zgjedhje të lira lokale, me votim të fshehtë. Mandati i anëtarëve të këshillit zgjat 4 vite.

Këshilli i komunës i kryen këto detyra:

-sjell Statutin e komunës dhe akte të tjera,

-e sjell buxhetin e komunës dhe llogarinë vjetore,

⁵⁴ Po aty, neni 54.

⁵⁵ Po aty, neni 63.

-e përcakton lartësinë e burimeve vetanake të të hyrave për financimin e komunës, të përcaktuara në suazat e ligjit,

-i aprovon vendimet dhe raportet për ekzekutimin e buxhetit dhe llogarisë vjetore të komunës,

-vendos mbi dispozitat për pronësinë e komunës dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Mbledhjet e këshillit mbahen sipas nevojës, por më së paku njëherë në tre muaj, me kërkesën e kryetarit, ose me kërkesën e më së paku $\frac{1}{4}$ të anëtarëve të këshillit. Këshilli mund të punoj nëse në seanca ka pjesëmarrjen e shumicës nga numri i përgjithshëm i antarëve të këshillit. Seancat e këshillit janë publike. Anëtarët e këshillit kanë të drejtën mbi kompenzimin për pjesëmarrje në seancat, në përputhje me ligj. Kryetari i këshillit zgjidhet nga antarët e Këshillit, me mandat katërvjeçar. Për Kryetar të këshillit zgjidhet kandidati që ka fituar shumicën e votave, nga këshilltarët.

a) Konstituimi i këshillit të Komunës së Gostivarit

Konstituimi i Këshillit bëhet me verifikimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të zgjedhur në mënyrë të përcaktuar me ligj dhe me vënien e nënshkrimit dhe dhënien e deklaratës solemne sipas përmbajtjes së përcaktuar me ligj.

Verifikimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit bëhet në seancën e parë konstituive të Këshillit, me propozimin e komisionit për çështjet e verifikimit, zgjedhje dhe emërime që formohen në fillim të seancës nga radhët e anëtarëve të posazgjedhur të Këshillit.

Verifikimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit që nuk kanë qenë të pranishëm në seancën e parë të Këshillit e bën në seancën e parë në të cilën do të marrin pjesë ata.

Procedura për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit përcaktohet për së afërmi me Rregulloren.

b) Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Këshillit.

Anëtari i Këshillit ka të drejtat dhe obligimet të përcaktuara me ligj dhe me këtë Statut. Anëtari i Këshillit i merr të drejtat dhe obligimet e veta pas verifikimit të mandatit.

Anëtari i Këshillit ka të drejtë dhe obligim:

të propozojë debat për çështje, dukuri dhe gjendje që janë me rëndësi vendore si dhe me rëndësi për qytetarët e komunës;

të ngrëjë iniciativa për nxjerrjen e vendimeve dhe akteve tjera nga kompetencat e Këshillit si dhe të propozojë amendamente në mënyrën dhe sipas procedurës të parashikuar me rregulloren;

të kërkojë nga administrata e Komunës si dhe nga shërbimet publike, institutet dhe ndërmarrjet dhe nga institucionet tjera të themeluara nga komuna, të dhëna dhe informata tjera për çështje nga fushëveprimi i vet e që janë të nevojshme për punën e tij në Këshill;

të kërkojë dhe të marrë ndihmë profesionale në përgatitjen e propozimeve të cilat ia paraqet Këshillit, në paraqitjen e pyetjeve të këshilltarëve dhe në kryerjen e punëve të tjera të cilat ia ka besuar Këshilli, gjegjësisht komisioni në të cilin është anëtar;

t'i ruaj si fshehtësi të dhënat të cilat janë klasifikuar si të tilla, që do t'i kuptojë në seancën e Këshillit apo të komisionit.

Anëtari i Këshillit ka të drejtë të jetë i pranishëm dhe të merr pjesë në punën e seancës të Komisionit të Këshillit, edhe pse nuk është anëtar i komisionit, por pa të drejtë vendosjeje.⁵⁶

Anëtari i Këshillit i cili me arsye ka munguar në seancat e Këshillit dhe të komisionit anëtar i të cilit është, është i obliguar që për këtë ta njoftojë në kohë kryetarin e Këshillit dhe kryetarin e komisionit si dhe sekretarin e Komunës.

Anëtari i Këshillit i cili me arsye një kohë të gjatë nuk ka marrë pjesë në seancat e këshillit dhe të komisionit anëtar i të cilit është, ka të drejtë të kërkojë nga Këshilli t'ia arsyetojë mospraninë në seancat.

Kryetari i këshillit e lejon arsyetimin pa debat nga ana e këshilltarit.

c) Kryetari i Këshillit të Komunës së Gostivarit

Kryetarin e Këshillit e zgjedh Këshilli me votim publik, me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Propozim për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit mund të jep çdo anëtar i Këshillit.

Zgjedhja e kryetarit të Këshillit mund të bëhet edhe me votim të fshehtë, nëse për një propozim të tillë të ndonjë anëtari të Këshillit, vendos Këshilli me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit.

⁵⁶ Po aty, Neni 10,13,14,15,16

Procedura për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit me votim të fshehtë rregullohet me Rregulloren.

d) Mënyra e punës e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Gostivarit

Këshilli punon në seanca të rregullta, kurse sipas nevojës mund të mbajë edhe seanca të jashtëzakonshme.

Dita, ora dhe vendi i mbajtjes së seancës së rregullt të Këshillit, si dhe propozimi i rendit të ditës sipas të cilit do të punojë seanca, shpallen në tabelën e komunës për shpallje.

Kryetari i Këshillit mund të vendosë, që dita, ora dhe vendi i mbajtjes së seancës së Këshillit si dhe propozimi i rendit të ditës të shpallet në mjetet e informimit publik.

Këshilli mban seanca solemne për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme historike, kurse mund të mbajë edhe seanca solemne edhe për dëgjimin e fjalimeve të qytetarëve tanë dhe të huaj, përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare dhe të qytetarëve të shquar të shteteve të huaja si mysafir të komunës.

Seanca e jashtëzakonshme thërritet për çështje me rëndësi për sigurinë e qytetarëve dhe në raste rrethanash të jashtëzakonshme.

Poashtu Këshillin e thërret kryetari i Këshillit me iniciativën e tij, ose me kërkesën e më së paku një të tretës të anëtarëve të Këshillit ose me propozimin e Kryetarit të komunës.

Ftesa për seancën e jashtëzakonshme bashkë me propozimin e rendit të ditës u dorëzohet anëtarëve të Këshillit në një afat të mundshëm sa më të shkurt.

Para fillimit të punës së seancës, anëtarët e Këshillit votojnë për arsyen e shkaqeve për thërritjen e seancës së jashtëzakonshme pa debat dhe me shumicë të anëtarëve të pranishëm në Këshill.⁵⁷

Në rast pengimi apo mosprezencës së kryetarit të Këshillit, seancat i kryeson anëtari më i vjetër i Këshillit.

Këshilli mund të vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, që votimi për disa çështje të bëhet në mënyrë të fshehtë.

⁵⁷ Po aty, Neni 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23

Thërritja e seancave të Këshillit, përcaktimi i rendit të ditës, rrjedha e seancës, procesverbalet, procedura e nxjerrjes së akteve dhe për çështje të tjera lidhur me punën e Këshillit, më së përafërmi rregullohen me Rregullore.

Kryetari i komunës i kryen kompetencat e veta në suazat e përcaktuara me ligj dhe me këtë Statut.

Po ashtu është i pranishëm dhe merr pjesë në punën e seancave të Këshillit kurse sipas nevojës edhe në seancat e komisioneve të Këshillit dhe të trupave të posaçëm të komunës pa të drejtë vendosjeje.

Mund të caktojë edhe përfaqësues të vet të cilët do të jenë të pranishëm dhe do të marrin pjesë në punën e seancave të Këshillit, të komisioneve të tij dhe të trupave punues të komunës.

Me iniciativën e vet dhe kërkesën e Këshillit e informon Këshillin për disa punë nga kompetencat e tij.

Siguron shfrytëzimin e drejtë dhe të ligjshëm, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës së komunës.

Udhëheq me pronën e komunës në interes publik dhe si nikoqir i mirë.

Është i obliguar që në udhëheqjen me pronën e komunës, të ndërmer masa dhe ta siguron shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës së komunës në pajtueshmëri me ligjin.

⁵⁸ Bashkëpunon me Kryetarët e komunave tjera për çështje me interes të përbashkët dhe në kompetencat e komunave.

Me vendim përcakton anëtarin e Këshillit i cili do ta zëvendësojë gjatë kohës kur ai është i penguar që të jetë i pranishëm. Vendimin e nxjerr në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së funksionit.

Vendimi shpallet në “Gazetën zyrtare të Komunës së Gostivarit”.

Për paraqitjen e pengesës apo mosprezencës, e informon kryetarin e Këshillit dhe anëtarin e Këshillit i cili do ta zëvendësojë.

⁵⁸ Po aty, Neni,23,24,25,26,27,28,29

Trupa të posaçëm të komunës

a) Komisioni për marrëdhënie midis bashkësive

Në komunë formohet Komisioni për marrëdhënie midis bashkësive.

Komisionin e përbëjnë nga (1) një përfaqësues i bashkësive të përfshirë në komunë, me mandat prej 4 (katër) vjetë.

Anëtarët e komisionit nuk mund të zgjidhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit.

Vendim për formimin e Komisionit merr Këshilli, me propozim të Komisionit për çështjet e verifikimit, zgjedhjeve dhe emërimeve.

Komisioni për çështjet e verifikimit, zgjedhjeve dhe emërimeve e formulon propozimin në bazë të propozimeve të marra paraprakisht nga partitë politike të përfshira në Këshill.

Komisioni nga radhët e anëtarëve të saj zgjedh kryetarin me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, me votim të fshehtë.

Komisioni punon në seanca.

Seancat i thërret dhe ato i udhëheq Kryetari i komisionit.

Komisioni mund të punojë nëse në seancë janë të pranishëm shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit.

Vendos me shumicë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit.

Në seancat e Komisionit mund të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në debat: Kryetari i komunës dhe kryetari i Këshillit, pa të drejtë vendosjeje.

b) Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve

Në komunë formohet Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve.

Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve është i përbërë nga 10 anëtarë, përfaqësues të grupeve më të mëdha të shfrytëzuesve të shërbimeve publike të komunave.

Anëtarët e Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve nuk mund të zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit të komunës.

Vendim për formimin e Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve merr Këshilli i komunës me propozimin e Komisionit për çështjet e verifikimit, zgjedhje dhe emërimë.

Komisioni për çështjet e verifikimit, zgjedhje dhe emërimë e formulon propozimin sipas propozimeve të marra paraprakisht nga format e vetvendosjes vendore në Komunë.

Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh kryetarin, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve, me votim të fshehtë.

Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve punon në seanca.

Seancat sipas rregullës janë publike (të hapura).

Seancat i thërret dhe me to udhëheq kryetari i Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve.

Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve mundet të punojë nëse në seancë janë të pranishëm shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve.

Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve vendosë me shumicë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve.

Mund të jenë të pranishëm dhe në punën e tyre mund të marrin pjesë, Kryetari i komunës dhe kryetari i Këshillit të komunës, pa të drejtë vendosjeje.⁵⁹

Shqyrton çështje dhe përcakton propozime që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimeve që ofrojnë shërbime publike të komunës, kurse posaçërisht: përcjell gjendjen e dhënies së shërbimeve nga ana e shërbimeve publike; kujdeset për zgjidhjen e problemeve që i kanë qytetarët gjatë shfrytëzimit të shërbimeve nga ndërmarrjet dhe institutet që kryejnë shërbime publike; kujdeset për përparimin e sjelljes së të punësuarve të dhënësit e shërbimeve ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve; organizon tribuna publike dhe forma tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve në të cilat do të debatohet për përparimin dhe mbrojtjen e shpenzuesve.

Trupi participues nga sfera e urbanizmit

Në komunë formohet trup participues nga sfera e urbanizmit (këshill) për të përcjellur qëndrimet dhe mendimet e qytetarëve dhe subjekteve juridikë në procesin e planifikimit urbanistik, si dhe për të përcjellë gjendjet dhe dhënien e iniciativave, orientimeve dhe sugjerimeve në procesin e planifikimit dhe përgatitjes së vendimeve planore për komunën.

Vendim për formimin e trupit participues nga sfera e urbanizmit merr Këshilli, me propozim të komisionit për çështje të verifikimit, zgjedhjeve dhe emërimeve.

⁵⁹ Po aty, Neni 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38

Përbëhen nga pesë anëtarë edhe atë nga sfera e urbanizmit atë zgjithen nga; nga radhët e anëtarëve të Këshillit; me propozimin e formave të vetvendosjes vendore; me propozimin e shoqatave të qytetarëve; shoqatave të personave profesionalë nga sfera e urbanizmit, dhe nga administrata komunale.

Nga radhët e anëtarëve të vet, zgjedh kryetarin, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të trupit participues, me votim public, punon në séance;

Seancat janë publike ,seancat i thërret dhe i udhëheq kryetari i Trupit participues nga sfera e urbanizmit.

Mund të punojë nëse në seancë merr pjesë shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Vendos me shumicë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Në seanca mund të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në punën e tyre, kryetari i komunës dhe kryetari i Këshillit, pa të drejtë vendosjeje.⁶⁰

Administrata e Komunes së Gostivarit

Administrata e komunës është kompetente për realizimin e punëve në suaza të Komunës, e shpërndarë në sektor dhe departamente. Të punësuarit në administratën e Komunës kryejnë punë profesionale, normativejuridike, ekzekutive, punë mbikëqyrëse dhe udhëheqëse dhe kryejnë punë të tjera, administrata ka status të nëpunësve shtetëror. Për punësimin e tyre, të drejtat dhe detyrimet, sistemin e rrogave dhe kompenzimeve, përgjegjësitë, vlerësimin dhe ndërprerjen e vendit të punës zbatohen nenet dhe rregullativat nga Ligji për nëpunësit shtetëror, dhe ligjet tjera. Administrata e komunës është e organizuar në sektorë dhe departamente si në vijim:

Komuna e Gostivarit posedon organet me të cilat funksionon dhe organizon punën e komunës, Kryetari i komunës është organ ekzekutiv.

Kompetencat kryesore të Kryetarit të janë:

- Shpall aktet dhe vendimet e Këshillit komunal;
- I propozon Këshillit komunal sjelljen e vendimeve dhe akteve tjera nga kompetencat e tij;
- Menaxhon me organin drejtues dhe administrativ;

- I emëron dhe i shkarkon personat udhëheqës në Organin drejtues dhe administrativ;
- Emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit arkitektonik të qytetit.⁶¹

Kemi të bëjme edhe me më shumë sektorë të rëndësishëm ku një ndër to është edhe Sektori për përkrahjen e Kryetarit të komunës ku në të janë të përfshirë:

-Departamenti për koordinimin e aktiviteteve të Kryetarit të komunës, informim dhe mardhënie me publikun,dhe

-Departamenti për zhvillim ekonomik lokal

Po ashtu organi më i rëndësishëm është edhe Sekretari i Komunës ku, puna, rendi dhe organizimi mvarret nga vete ai, kurse Sekretari i komunes raporton vetëm tek Kryetari i komunes.

Organet tjera të Komunës janë:

Sektori për çështje juridike që merret me të gjitha procedurat gjyqësore që kanë të bëjnë me komunën duke përfshirë edhe çështje juridike të vetë komunës, ku merret me punët normative juridike, për përkrahjen e Këshillit të Komunës së Gostivarit dhe për përkrahjen dhe punët e përgjithshme.

- Sektori për punë juridike, të përgjithshme dhe organizative:

- Departamenti për punë normative-juridike
- Departamenti për përkrahjen e Këshillit të komunës
- Departamenti për përkrahje informatike dhe punë të përgjithshme

Sektori për punë financiare pranë Komunës së Gostivarit merret me koordinimin e buxhetit të komunës, kontrollimin e buxhetit, për kontabilitet, pagesat e rrogave, për tatimin, taksa, kompenzim dhe për të hyra të tjera të komunës dhe për furnizime publike.

- Sektori për çështje financiare:

- Departamenti për koordinimin e buxhetit
- Departamenti për kontrollin e buxhetit
- Departamenti për kontabilitet dhe pagesa
- Departamenti për tatime, taksa, kompenzime dhe për të hyra të tjera të komunës.
- Departamenti për furnizime publike

⁶¹ Ligji për vetëqeverisje lokale, neni, 48.

Sektori për urbanizëm pranë komunës më së shumti merret me ndërtimtari dhe planifikim hapsinor, administrimin e tokës ndërtimore, për planifikimin dhe zhvillim e komunikacionit në rajonin e komunës dhe për veprimtaritë komunale dhe mbrotje të mjedisit jetësor.

- **Sektori për urbanizëm, komunikacion, veprimtari komunale dhe mbrotje të mjedisit jetësor:**

- Departamenti për urbanizëm, ndërtimtari dhe planifikim hapsinor
- Departamenti për rregullimin dhe administrimin e tokës ndërtimore
- Departamenti për planifikimin dhe zhvillimin e komunikacionit, në rajonin e Komunës
- Departamenti për veprimtari komunale dhe mbrotje të mjedisit jetësor

Sektori për veprimtari publike pranë Komunës së Gostivarit merret me veprimtari për arsimin, kulturën dhe sportin, për mbrotje shëndetësore ,sociale dhe të fëmijëve, dhe mbrotje dhe shpëtim.

- **Sektori për veprimtari publike**

- Departamenti për arsim, kulturë dhe sport
- Departamenti për mbrotje shëndetsore, sociale dhe të fëmijëve dhe mbrotje dhe shpëtim
-

Sektori për çështje inspektuese pranë komunës mban inspektimin pranë komunës së Gostivarit duke përfshirë edhe mjedisin jetësor , inspekcionin urbanistik-ndërtimor dhe lloje të tjera inspektuese nga kompetecat e Komunës.

- **Sektori për mbikqyrje inspektuese**

- Departamenti për inspekcion komunal dhe inspekcion për mjedis jetësor
- Departamenti për inspekcion urbanistik-ndërtimor
- Departamenti për lloj tjetër të mbikqyrjes inspektuese nga kompetecat e komunës

- **Departamenti për revizion të brendshëm**

- **Departamenti për menaxhim me resurse njerëzore**

- **Njësia territoriale kundër zjarrit e Komunës së Gostivarit**


Organogrami i Komunës së Gostivarit

Këshilli i Komunës së Gostivarit

Nr. 07-920/1; 12.06.2013

Gostivar

Organogrami i Komunës së Gostivarit



1.2 Bashkëpunimi i Komunës së Gostivarit me Komunat mbrenda vendit

Në kryerjen e kompetencave të veta komunat mund të bashkëpunojnë ndërmjet veti.

Me qëllim të realizimit të interesave të përbashkëta dhe kryerjen e punëve të përbashkëta në kompetencën e komunave, ato mund të bashkohen mjete dhe të formojnë veprimtari të përbashkëta publike, në përputhje me ligjin, e kryerjes së kompetencave të veçuara ku komunat mund të formojnë trupa të përbashkëta administrative në lëmenj të caktuara në përputhje me ligjin.

Komunat mund të bashkëpunojnë edhe me njësi të vetëqeverisjes lokale të shteteve të tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare të bashkësive lokale, si dhe të anëtarësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve lokale.

Ministria kompetente për kryerjen e punëve që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale mban evidencë për bashkëpunimin e realizuar ndërkombëtar të Komunave, në përputhje me ligjin.

Thelbi i bashkëpunimit ndërkomunal rrjedh nga nevoja e njësive të vetëqeverisjes lokale të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për zgjidhje të problemeve të përbashkëta për dy ose më tepër komuna, me qëllim të arritjes së efektit pozitiv për qytetarët e komunave, të cilat bashkëpunojnë ndërmjet tyre.⁶²

Nuk ka dyshim se lidhja e marrëveshjeve të njësive të vetëqeverisjes lokale mes tyre, ndikon në zhvillimin e vetëqeverisjes lokale.

Me qëllim të mbrojtjes dhe përparimit të interesave të përbashkëta, komuna me vendim të miratuar nga Këshilli i komunës ka mundësi:

- Të bashkohet në shoqata në pajtim me ligjin;
- Të sjell vendim, që së bashku me komunat tjera të Republikës të bashkojë mjete dhe të formojë shërbime publike të përbashkëta, me qëllim të realizimit të interesave të përbashkëta dhe kryerjes së punëve të përbashkëta nga kompetencat e tyre, në pajtim me ligjin;

-

Në marrëveshje me komuna të tjera, të formojnë trupa të përbashkët administrativ në sfera të caktuara, me qëllim të zbatimit të kompetencave të caktuara në pajtim me ligjin.⁶³

⁶² “Doracak për kryetarët dhe këshilltarët e komunave në R.M.Shkup,2005,fq.133.

⁶³ Statuti i Komunës së Gostivar, neni 6.

Komuna sjell vendime për bashkëpunim me komunat e Republikës, me njësitë e vetëqeverisjes lokale të vendeve të tjera si dhe me organizatat ndërkombëtare të bashkësive vendore dhe pushteteve lokale.

Poashtu mund të antarësohet në organizatat ndërkombëtare të pushteteve lokale. Këshilli i komunës, me qëllim të mbrojtjes dhe përparimit të interesave të përbashkëta me komunat tjera, sjell vendim që komuna të bashkohet në Shoqatën e komunave të Republikës së Maqedonisë.

Bashkëpunimi me pushtetin Qendror është në nivel sidomos rreth koordinimit të disa punëve që janë nevojë e patjetërsueshme e qytetarëve.

Shpallje të vendimit për vërtetimin e propozimit për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal, për vërtetimin e propozimit për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal.

Një nga bashkëpunimet e para të komunës ishte ne periudhën e vitit 2010 ku në seancën e dhjetë të datës 30.03.2010 e mbajtur për vërtetimin e propozimit për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal ku të parashtruar nga Kryetari i komunës për përcaktimin dhe shënimin e emrave të rrugëve ndërmjet Komunës së Gostivarit dhe Komunës së Vrapçishtit. Propozimi i vërtetuar nga ana i këtij vendimi, vlerësimi për nevojën e vendosjes së BNK dhe mendimit të Kryetarit të komunës.⁶⁴

Në të njetën periudhë të dates 30.03.2020 shpalljen e vendimit për vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Gostivarit dhe Bashkësisë lokale f. Debresh, për shkak të ndërtimit të ujësjellësit-rezervoarit për ujë për pije në f. Debresh.

Me këtë vendim Këshilli i Komunës së Gostivarit e pranon propozimin për vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Gostivarit dhe Bashkësisë lokale f. Debresh, për shkak të ndërtimit të ujësjellësit-rezervuarit të ujit për pije në f. Debresh dhe rregullohet mënyra, kushtet, financimi dhe çështje tjera.

Në realizimin e këtij bashkëpunimi do të merr pjesë me mjete financiare të siguruara nga Buxheti i Komunës së Gostivarit për vitin 2010, që mund të shfrytëzohen ekskluzivisht për destinimin e vërtetuar të këtij vendimi.

Në periudhën e datës së: 30.08.2010, solli vendim për formimin e komisionit për marrëdhënie në mes të bashkësive Me këtë vendim formohet komisioni për marrëdhënie në mes të bashkësive si komision i përhershëm i Komunës së Gostivarit. Si anëtarë të komisionit emërohen ,mandati i anëtarëve të komisionit zgjatë 4 vite;

⁶⁴ Buletini Zyrtar i Komunës së Gostivarit” Nr. 3 30.03.2010 faqe 32,33
Po aty, Nr. 6 30.08.2010 faqja 34 MC Neni 3

1. Vesel Memedi
2. Shasine Kasami
3. Boban Markovski
4. Arif Pini

Do të përgatisë propozim-aktet për themelim ose formim të formave përmes të cilave do të realizohet bashkëpunimi ndërkomunal. Komisioni i përbashkët i dorëzon propozim-aktet deri te këshillat e komunave të cilët vendosin bashkëpunim ndër-komunal në afat prej 10 ditësh.

Komisioni i përbashkët është i përbërë prej 6 anëtarëve, nga të cilët 3 anëtarë nga secila Komunë do të vendosin për bashkëpunim ndërkomunal. Komisioni nga radhët e veta zgjedh Kryetar, i cili e koordinon punën e komisionit. Në punën e komisionit mund të marrin pjesë edhe persona profesional nga fusha në të cilën vendoset bashkëpunimi ndër-komunal.

Në periudhën e vitit 29.10.2010, u vendos vërtetimi propozim për bashkëpunim ndërkomunal për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës, ndërmjet Komunës së Gostivarit, Komunës së Vrapçishtit dhe Komunës Mavrovë-Rostushë. Propozimi i vërtetuar nga e këtij vendimi, vlerësimi për nevojën e vendosjes së BNK.⁶⁵

Po në të njëjtën periudhë u formua komisioni i përbashkët për bashkëpunim ndërkomunal, që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 27.12.2010.

.Ky komisioni i përbashkët për BNK: -do të përgatisë propozim-aktin për vendosje të BNK; -do të përgatisë propozim-aktet për themelim ose formim të formave përmes të cilave do të realizohet bashkëpunimi ndër-komunal. Komisioni i përbashkët i dorëzon propozim-aktet deri te këshillat e komunave të cilët vendosin bashkëpunim ndër-komunal në afat prej 10 ditësh.

Komisioni i përbashkët është i përbërë prej 9 anëtarëve, nga të cilët 3 anëtarë nga secila Komunë të cilat vendosin bashkëpunim ndër-komunal.

Komisioni nga radhët e veta zgjedh Kryetar, i cili e koordinon punën e komisionit. Në punën e komisionit mund të marrin pjesë edhe persona profesional nga fusha në të cilën vendoset bashkëpunimi ndër-komunal. Komisioni nga ana e këtij Vendimi, propozimet e akteve i përgatit në bazë të analizës së përgatitur paraprakisht.

⁶⁵Po aty, Nr. 8 05.11.2010 faqja 36,37
Po aty Nr. 10 27.12.2010 faqja 188,189,190

1.3 Bashkëpunimi i Komunës së Gostivarit me Komunitat jashtë vendit

Komuna e Gostivarit si të gjitha komunitat tjera, gjatë periudhës së funksionimit të saj ka bashkëpunuar me shumë komunitat tjera si mbrenda vendit ashtu edhe jashtë vendit.

Një ndër bashkëpunimet e para ka qenë gjatë periudhës së vitit 2010, ku në mbledhjen e VIII të datës 29.01.2010 vendosi për miratim të iniciativës për vëllazërim ndërmjet Komunës së Gostivarit me Komunën e Fatih pjesë e bashkësisë së Stambollit Republika e Turqisë.

Bashkëpunim të kësaj natyre kemi edhe gjatë periudhës në vazhdim, në viti 2012 komuna e Gostivarit vëllazërohet me Komunën Bor R. e Turqisë.

Ky lloj dhe mënyra e bashkëpunimit në mes të Komunave do të përcaktohet me marrëveshje të posaçme, ku autorizohet Kryetari i Komunës së Gostivarit që të nënshkruaj Marrëveshje për vëllazërim me Komunën Bor R. e Turqisë.

Iniciativa të kësaj natyre vazhdojnë edhe në vitet në vazhdim ku gjatë periudhës së vitit 2013 këshilli i Komunës së Gostivarit shpalli vendim për vëllazërim të Komunës me Komunën e Stari Gradit R. e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Si me të gjitha Komunitat, ashtu edhe me Komunën e Stari Gradit të R. së Bosnjës dhe Hercegovinës kryetari përcaktohet që të nënshkruaj marrëveshje të posaçme.

Në seancën e mbajtur më datë 30.07.2014. këshilli i Komunës solli vendim për kofinancim të projektit IPA për bashkëpunim ndërkufitar „Zhvillimi i produktit turistik të integruar për rritje të qëndrueshme ekonomike të rajonit të Gostivarit dhe Korçës" Shpallet Vendim për kofinancim të projektit IPA për bashkëpunim ndërkufitar „Zhvillimi i produktit turistik të integruar për rritje të qëndrueshme ekonomike të rajonit të Gostivarit dhe Korçës",

Me këtë Vendim kofinancohet projekti IPA për bashkëpunim ndërkufitar „Zhvillimi i produktit turistik të integruar për rritje të qëndrueshme ekonomike të rajonit të Gostivarit dhe Korçës". Vlera e përgjithshme e këtij projekti është 244.698,87 Euro, ku Komuna e Gostivarit bashkëfinancon 30% të kësaj vlere 73.410 Euro, me çka 15% e vlerës pas përfundimit të projektit do të kthehet në Buxhet të Komunës nga Ministria për vetëqeverisje lokale. Kohëzgjatja e projektit “Zhvillimi i produktit turistik të integruar për rritje të qëndrueshme ekonomike të rajonit të Gostivarit dhe Korçës" është 20 muaj.

Komuna e Gostivarit me qytetin e Adanës - Republika e Turqisë në periudhë të viti 2014 bënë vëllazërim të Komunës me qytetin e Adanës - Republika e Turqisë.

Lloji dhe mënyra e bashkëpunimit në mes të Komunës së Gostivarit dhe qytetit të Adanës - Republika e Turqisë, do të përcaktohet me marrëveshje të posaçme. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gostivarit që të nënshkruaj Marrëveshjen për vëllazërim të komunës së Gostivarit me qytetin e Adanës - Republika e Turqisë. ⁶⁶Shpallet Vendim për vëllazërim të Komunës së Gostivarit me Komunën Galaci, Republika e Rumanisë, që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 28.07.2015.

⁶⁷Më datë 09.06.2017 shpallet Vendim për vëllazërim të Komunës së Gostivarit me komunën e Ejupit (Stamboll) - Republika e Turqisë.

Komuna e Gostivarit me komunën e Sveta Nedelja (Kroaci) - Republika e Kroacisë më datën 23.04.2018 solli vendim për vëllazërim midis dy ⁶⁸Komunave ku u vendos edhe bashkëpunimi në shumë sfera të tjera.

Gjatë periudhës së vitit 2018 u vendos bashkëpunimi ndërkomunal me komunat Bërvenicë, ⁶⁹Vrapçisht, Gostivar, Jegunovcë, Mavrovë dhe Rostushë, Tearcë, Tetovë dhe Zhelinë që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 19.06.2018

Me këtë Vendim vendoset bashkëpunimi ndërkomunal me komunat Bërvenicë, Vrapçisht, Gostivar, Jegunovcë, Mavrovë dhe Rostushë, Tearcë, Tetovë dhe Zhelinë për mbrojtje dhe shpëtim të qytetarëve dhe të të mirave materiale nga përmbytjet dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe të natyrës.

⁷⁰Për vëllazërim të Komunës së Gostivarit me komunën e Kilis - Republika e Turqisë, që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 21.09.2018.

Komunës së Gostivarit në vitin e fundit në periudhën e muajt 25.09.2020 është vëllazuar me dy komuna edhe atë me komunën e Kytahja - Republika e Turqisë dhe me komunën e Maltepe/Stanboll - Republika e Turqisë, që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 25.09.2020.

⁶⁶ Po aty , Numri 6 28.07.2015

⁶⁷ Po aty, Numri 4 09.06.2017 Faqja [1]

⁶⁸ Po aty, "Numri 6 23.04.2018 Faqja [18]

⁶⁹ Po aty ,Numri 7 19.06.2018 Faqja [133,144]

⁷⁰ Po aty, Numri 9 21.09.2018 Faqja [28]

1.5 Bashkëpunimi i Komunës së Gostivarit me organet e pushtetit qendror

Organet shtetërore , sipas LVL, janë të detyruara në afat të caktuar dhe në mënyrë adekuate t'i konsultojnë organet komunale kur vendosin për çështje që u dedikohen atyre. Mënyra e konsultimeve përcaktohet me ligjet nga sfera përkatëse.

Konsultimet janë të domosdoshme edhe gjatë përgatitjes së planit hapsinor të Republikës.

Bashkëpunimi zhvillohet edhe nëpërmjet lidhjes së kontratave ndërmjet shtetit dhe komunave. Qeveria, për shkak të koordinimit gjatë planifikimit, programimit dhe implementimit të politikave në sfera të caktuara, mund të lidhë kontrata për bashkëpunim me një ose më shumë komuna, për çka informohet Kuvendi i RM.

Sipas ligjit, Qeveria është e detyruar të bashkëpunojë me komunat kur sillen ligje që u dedikohen komunave; kur përcaktohet shuma e dotacionit të përgjithshëm që duhet tu ndahet komunave në vitin vijues kalendarik; si dhe për burimin e financave dhe të kompetencave. Më tutje, Ligji insiston të përgatitet raport në të cilin do të evidentohen çështjet për të cilat është arritur pëlqim dhe për ato për të cilët nuk është arritur pëlqim.

Gjatë propozimit të ligjit që i prek interesat e komunave , atij detyrimisht i shtohet raporti i lartpërmendur. LVL përmban dispozita themelore për Shoqatën e komunave të RM, si institucion për mbrojtje dhe përparim të interesave të përbashkëta të komunave.

Duke u nisur nga e drejta e bashkimit të komunave në forma të ndryshme fakultative, thuhet se shoqata e cila përfshin më tepër së dy të tretat nga komunat në tërë territorin e shtetit ka të drejtë të prezantohet si përfaqësues legjitim i komunave , gjegjësisht të bashkëpunojë me Qeverinë në emër të tyre, të inicojë sjellje të ligjeve që u dedikohen përparimit të vetëqeverisjes lokale, si dhe të japë propozime për projektimin e propozimit të buxhetit ri të RM në pjesën që i dedikohet ndarjes së mjeteve të komunave për kryerjen e kompetencave të përcaktuara me ligj.

Gjithashtu, shoqata e komunave e RM, në të cilën bëjnë pjesë më tepër se dy të tretat nga komunat e përfaqëson RM në organizatat ndërkombëtare të pushteteve lokale dhe bashkëpunon me organizata të përfaqësuara nga vende të tjera. Themelimi, organizimi, funksionimi, dhe regjistrimi i shoqatës rregullohet me ligj të veçantë.⁷¹

⁷¹ Po aty, Numri 8 08.11.2013 Faqja 39,40

Për shpallje të Plan-Programit për zhvillim për Komunën e Gostivarit për vitin 2014 që e propozoi Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 08.11.2013.

PLAN -PROGRAM PËR ZHVILLIM për komunën e Gostivarit për vitin 2014 .

Gjatë planifikimit të programit zhvillimor shfrytëzohen instruksionet nga Ministria e Financave për planifikimin e programeve zhvillimore përmes të cilave pasqyrohen mjetet e planifikuara në programe dhe nënprograme nga pjesa zhvillimore e Buxhetit të komunës. Plani i miratuar i programit zhvillimor është pjesë përbërëse e Propozim-Buxhetit të komunës së Gostivarit.

1.5 Bashkëpunimi i Komunës së Gostivarit me fondet dhe organizatat ndërkombëtare

Në periudhën e vitit 2010 Komuna e Gostivarit, shpalli Aktvendim për emërim të anëtarëve të komisionit të përbashkët për bashkëpunim ndërkomunal për implementim të projektit të UNDP BNK, që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 27.12.2010

Këshilli i Komunës së Gostivarit, në seancën e 16-të të mbajtur më datë 27.12.2010, për emërim të anëtarëve të komisionit të përbashkët për bashkëpunim ndërkomunal për implementim të projektit të UNDP BNK

1. Për anëtarë të komisionit të përbashkët për bashkëpunim ndërkomunal, për implementim të projektit të UNDP BNK: -

-Dashmir Osmani- Seksioni për zhvillim ekonomik lokal dhe implementimin e projekteve

-Maja Minoska -Sektori për urbanizëm, punë komunale, komunikacion dhe mbrojtje të mjedisit jetësor

-Toni -Serafimoski Seksioni për mbikqyrje inspektuese.

Kryetari i Komunës së Gostivarit, në vitin 2011 solli vendim për pjesëmarrje dhe angazhim në projektin drejtuar Ambasadës Japoneze, që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë ⁷²10.03.2011.

Me këtë Vendim u dakorduan se Komuna e Gostivarit merr përsipër të gjitha angazhimet dhe pjesëmarrjen e Administratës së Komunës së Gostivarit në të gjithë procedurën nga Aplikacioni që i drejtohet Ambasadës së Japonisë në Vjenë – Grandit për Asistencë për Projekte Themelore dhe që ka të bëjë me intervenimet dhe renovimet e domosdoshme në Kopshtin fëmijëror “Gëzimi fëmijëror”.

Kopshti fëmijëror gjegjësisht njësia e saj “Pranvera” që gjendet në rrugën Beliçica e cila ka nevojë për renovimin e ujësjellësit dhe kanalizimit, vendosjen e pllakave dhe pajisjeve sanitare si dhe për ndërtimin e murit nga betoni përreth këtij kopshti, e deri te mbikqyrja e të gjithë projektit dhe realizim të së njëjtës.

Administrata e Komunës së Gostivarit, do të angazhohet të plotësojnë Aplikacionin e nevojshëm, dokumente të tjera përcjellëse si dhe do të marrin pjesë në realizimin e aktiviteteve të parapara në projekt. Komuna e Gostivarit merr përsipër ko-financimin e këtij aktiviteti sipas nevojës, edhe atë nga 5% deri më 10% nga vlera e përgjithshme e projektit.

⁷² Po aty, Numri 11 10.03.2011 Faqja 183

Në fazën implementuese të këtij projekti, Komuna e Gostivarit së bashku me IPKF “Gëzimi Fëmijëror” do të angazhohet rreth implementimit të këtij projekti duke përgatitur raportet dhe dokumentet tjera përcjellëse për realizimin e këtij aktiviteti. Arsyetim, Komuna e Gostivarit duke marrë parasysh gjendjen dhe kërkesat e drejtuara nga Institucioni Publik Kopshti Fëmijëror “Gëzimi fëmijëror”, gjegjësisht njësia “Pranvera”, për renovimin e pajisjeve sanitare si dhe intervenimet e nevojshme për ndërtimin e murit të betonit, merr përsipër dhe angazhohet për të përmbushur nevojat e këtij Institucioni publik.

Nevoja për të rinovuar nyjet sanitare dhe rrethojën e këtij institucioni, janë të domosdoshme. Objekti i kopshtit, që nga ndërtimi në vitin 1968, nuk ka pasur intervenime dhe gjendja e tij është vështirësuar dukshëm me çka nuk përmbush standardet dhe normat bashkëkohore për punë. Gjendjen e këtillë e vërteton edhe Vendimi dhe Raporti i Inspektoratit shtetëror sanitar dhe shëndetësor si dhe Institucioni publik për mbrojtje shëndetësore.

Zyra për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe implementim të projekteve, gjegjësisht të punësuarit në administratën komunale, janë angazhuar në përpilimin e dokumentacionit të nevojshëm për të aplikuar në Ambasadën Japoneze në Vjenë, përmes Sektorit për Çështje Evropiane pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Sipas obligimeve që dalin nga projekt-aplikacioni, është përgatitur dokumentacioni teknik, edhe atë: - Oferta nga katër ndërmarrje private për realizimin e murit të betonit, si dhe katër oferta për renovimin e kanalizimit, ujësjellësit dhe ndërrimin e pllakave dhe pajisjeve sanitare në kopshtin “Pranvera” që gjendet në rrugën Beliçica. Aplikacioni dhe dokumentet tjera përcjellëse janë përgatitur dhe të njëjtat do të dorëzohen për miratim në Ambasadën Japoneze. Angazhimet rrjedhëse rreth këtij projekti do të pasojnë pas shqyrtimit dhe miratimit të tij.

Komunës së Gostivarit dhe në lidhje me Ligjin për huamarrje të Republikës së Maqedonisë të një kredie nga Banka Evropiane e Investimeve sipas Marrëveshjes për hua mbi Projektin ⁷³“Furnizimi me ujë dhe largimin e ujerave të zeza”, Këshilli i komunës së Gostivarit në seancën e mbajtur më 28.06.2011, jep PROJEKT – DEKLARATË se Komuna e Gostivarit i plotëson kushtet e mëposhtme Komuna e Gostivarit ka themeluar Ndërmarrjen publike “Komunalec” - Gostivar, e cila merret me furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të zeza.

NP “Komunalec” - Gostivar mbulon shërbimet në lidhje me furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të zeza dhe nuk është e ngarkuar me borxhe që do ta sjellin në pyetje funksionimin e saj. NP “Komunalec” - Gostivar me tarifë të përcaktuar, mundëson mbulim të shpenzimeve për operimin aktual dhe të ardhshëm dhe zhvillim të projektit. Projektet me të cilat komuna do të aplikojë do të miratohen me vendim të Këshillit të Komunës, për secilin projekt veç e veç. Të gjitha projektet e financuara deri më tani për furnizimin me ujë dhe largimin e

⁷³ Po aty, Numri 13 28.06.2011 Faqja 2,3

ujërave të zeza në Komunën e Gostivarit prej donacioneve nga shteti apo institucionet ndërkombëtare, janë realizuar dhe janë në fuksion.

Nëse komuna nuk i plotëson kushtet nga deklarata e dhënë, obligohet që t'i kthejë mjetet në tërësi. Shënim: nëse Komuna aplikon për projekte me vlerë më të madhe se 3.000.000,00 euro, është e nevojshme të bëjë një deklaratë në lidhje me pikën 6 të kushteve, rrespektivisht se do të përgatisë një studim Fizibiliteti.

Komuna e Gostivarit në mbledhjen të mbajtur më datë 15.08. 2011, solli vendim për huazim të ⁷⁴Komunës së Gostivarit për mjete financiare nga Republika e Maqedonisë (Për huazim afatgjatë on-lending, për përmirësimin e shërbimeve komunale të finansuara nga Banka ndërkombëtare për rekonstruim dhe zhvillim (Banka botërore) Në Komunë janë huazuar mjete financiare nga Republika e Maqedonisë, në kohë afatgjatë on-lending nga Banka ndërkombëtare për rekonstruim dhe zhvillim (Banka botërore), në shumë prej 61.300.000,00denarë, gjegjësisht 1.000.000euro, për finansimin e projekteve kapitale dhe investimeve, të dedikuara për:

- Furnizim me mjete themelore për mirëmbajtje të higjienës publike në territorin e Komunës në vlerë prej 31.324.300,00denarë (511.000euro)
- Ndërtim të rezervoarit (të ujës-jellësit) në Fshatin Debresh në vlerë prej 8.687.298,00denarë(141.718 euro)

Përmirësim të ndriçimit public zëvendësim të dritave ekzistuese me ato kursyese në vlerë prej 21.288.402,00 denarë (347.282euro) Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga ana e këtij vendimi do të përcaktohet me Kontratë që do të lidhet në mes Komunës dhe Qeverisë .

Kontratën për huazim nga Banka ndërkombëtare do ta nënshkruaj Kryetari i Komunës. Afati i pagesës së huas nga ana e këtij vendimi është 10 (dhjetë) vite, me grejs periudhë prej 3 (tri) vjet. Kamata vjetore është LIBOR gjashtë mujor për euro valutën me variacion variabil. Komuna e Gostivarit, kredinë nga ana e këtij vendimi do ta paguaj nga Buxheti i Komunës së Gostivarit, në këste gjysmëvjetore.

“Kryçjen e fëmijëve Rom në entet parashkollore në Republikën e Maqedonisë” sollën vendim për ndimë të mjeteve për qëndrim dhe ushqimin e fëmijëve Romë në lidhje me projektin” që⁷⁵ Këshilli i Komunës e solli në seancën e mbajtur më datë 21.10.2011.

Në bashkëpunim të lidhur ndërmjet Ministrisë për punë dhe politikë sociale, Komunës së, IPKF “Gëzimi Femijërorë”-Gostivar. Shuma e mjeteve për qëndrim dhe ushqimin e fëmijëve

⁷⁴ Po aty, Numri 14 15.08.2011 Faqja 4,5

⁷⁵ Po aty, Numri 16 21.10.2011 Faqja 77

Romë arrin shumën 750 euro në kundërvlerë denar, dhe të njëjtat do të realizohen për vitin shkollor 2009-2010 dhe 2010-2011, ⁷⁶mjetet do të lëshohen drejtpërdrejt në llogari të IPKF “Gëzimi Femijrorë”-Gostivar.

Një ndër projektet më të rëndësishme u soll në vitin 2010 dhe 2011 ku u financua me mjete financiare nga Republika e Maqedonisë (Për huazim afatgjatë on-lending, në suaza të Projektit për përmirësimin e shërbimeve komunale të finansuara nga Banka ndërkombëtare për rekonstruim dhe zhvillim (Banka botërore) Komuna në atë periudhë huazon mjete financiare nga Republika e Maqedonisë, në kohë afatgjatë on-lending nga Banka ndërkombëtare për rekonstruim dhe zhvillim (Banka botërore), në shumë prej 61.300.000,00 denarë, gjegjësisht 1.000.000euro, për finansimin e projekteve kapitale dhe investime, të dedikuara për:

- Furnizim me mjete themelore për mirëmbajtje të higjienës publike në territorin e Komunës së Gostivarit
- Ndërtim të rezervoarit (të ujësjellësit) në Fshatin Debresh
- Përmirësim të ndriçimit publik zëvendësim të dritave ekzistuese me ato kursyese Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga ana e këtij vendimi do të përcaktohen me Kontratë që do të lidhet në mes Komunës së Gostivarit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Në emër të Komunës së Gostivarit, Kontratën për huazim nga ⁷⁷ do ta nënshkruaj Kryetari i Komunës së Gostivarit. Afati i pagesës së huas nga ana e këtij vendimi është maksimum 10 (dhjetë) vite, me grejs periudhë prej 3 (tri) vjet. Afati i fundit i pagesës së kredisë është shkurti i vitit 2022. Kamata vjetore është LIBOR gjashtë mujor për euro valutën me variacion variabil. Komuna e Gostivarit, kredinë nga ana e këtij vendimi do ta paguaj nga Buxheti i Komunës së Gostivarit, në këste gjysmëvjetore, u soll
KONKLUZIONI për dhënie të pëlqimit projektit të OSBE-së “Shkolla të sigurma-Mjedis harmonik” Shpallet KONKLUZIONI për dhënie të pëlqim projektit të OSBE-së “Shkolla të sigurma- Mjedis harmonik,⁷⁸ që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 17.08.2012
- 2. Pjesë përbërëse e këtij Pëlqimi është edhe projekti i OSBE-së “Shkolla të sigurma- Mjedis harmonik”.⁷⁹

Organizata Ndërkombëtare “UNICEF” më datë: 27.12.2013 sjell vendim për përkrahje të përbashkët me Komunën, për përkrahje financiare të⁸⁰ projektit të përbashkët me Organizatën Ndërkombëtare “UNICEF” në Komunën e Gostivarit.

⁷⁶ Po aty, Numri 16 21.10.2011 Faqja 78

⁷⁷ Po aty, Numri 1 27.01.2012 Faqja 2,3

⁷⁸ Poaty, Numri 9 17.08.2012 Faqja 85

⁷⁹ Po aty, Numri 9 17.08.2012 Faqja 87

Me këtë Vendim ndahen mjete finansiare nga Buxheti i Komunës së Gostivarit për vitin 2014 për projektin e përbashkët me Organizatën Ndërkombëtare “UNICEF” dhe Komuna e Gostivarit për rekonstruim të hapësirës për investime për fëmijët në të cilën do të realizohet programi për zvogëlimin e stresit dhe traumave nga dhuna në familje.

Mjetet të cilat i ndahen institucionit të cekur më lartë janë në vlerë prej 370.000,00 denarë, të parapara në programën VA, në pozicionin 482 –objekte tjera ndërtimore.

Në datën 10.03.2014, sollen konkluzione për miratim të Planit Strategjik të Këshillit Lokal Ekonomiko Social të Komunës së Gostivarit ⁸¹

1. MIRATOHET Plani Strategjik i Këshillit Lokal Ekonomiko Social të Komunës së Gostivarit.

Pikërisht në atë periudhë u bë shpallje për Vendim kofinancim për hartim të Strategjisë për zhvillim të komunës së Gostivarit me ARTI FUTURE nga Sllovenia.⁸²

Në bazë të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, vlera e përgjithshme e hartimit të strategjisë për zhvillim të komunës së Gostivarit me ARTI FUTURE është 40.000 Euro, ndërsa Komuna kofinanon në vlerë prej 4.000 euro.

Shkollën e mesme Ekonomike Komunale ”Gostivar” – Gostivar, financuar nga USAID-i për kofinancimin e projektit për ndërrimin e dritareve të Shkollës së mesme, financuar nga USAID-i, në vitinë 2014 në bazë të memorandumit për bashkëpunim të lidhur në mes USAID-it, Qendrës Maqedonase për edukim qytetarësh dhe komunës së Gostivarit me datë 12.06.2014.

⁸⁰ Po aty, Numri 10 27.12.2013 Faqja 3,4,5

⁸¹ Po aty, Numri 2 10.03.2014 Faqja 213,214

Vlera e përgjithshme e projektit për ndërrimin e dritareve në Shkollën e mesme Ekonomike Komunale "Gostivar"- Gostivar është 791.364,00 den, ndërsa Komuna kofinancon në vlerë prej 79.136,00 den ose 10% nga vlera e përgjithshme e projektit .⁸³

Projekti për ndërrimin e dyshemesë dhe rekonstruimin e dy klasave në shkollën fillore "Çajla" - fshati Çajlë, komuna e Gostivarit financuar nga USAID-i, në bazë të memorandumit për bashkëpunim të lidhur në mes USAID-it, Qendra Maqedonase për edukim qytetarësh dhe komunës së Gostivarit me datë 12.06.2014. ⁸⁴Vlera e përgjithshme e Projekti për ndërrimin e dyshemesë dhe rekonstruimin e dy klasave në shkollën fillore "Çajla"- fshati Çajlë është 1.269.467,00 den, ndërsa Komuna kofinancon në vlerë prej 126.946,00 den ose 10% nga vlera e përgjithshme e projektit.

Për pranimin e mjeteve financiare nga Programi Forume në bashkësi, Komuna e Gostivarit në seancën e 14-të të mbajtur më 04.11.2014, solli vendim për pranimin e mjeteve financiare nga Programi Forume në bashkësi, Me këtë Vendim do të financohen aktivitetet e parapara për organizimin e Forumit buxhetor, gjegjësisht përmes participimit qytetar do të miratohet buxheti i Komunës për vitin 2015. Ky program do të realizohet në periudhën nga tetori i vitit 2014 deri në tetor vitit 2015. Mjetet e fituara do të realizohen në sajë të buxhetit të planifikuar për vitin 2014 dhe 2015. Aktivitetet e këtij programi në vlerë prej 825.000,00 denarëve do të financohen nga ana e Agjencionit Zviceran për bashkëpunim dhe zhvillim.

Projektit IPA për bashkëpunim ndërkuftar Maqedoni –Kosovë "Turizmi – Dera e hapur për bashkëpunim ndërkuftar", me këtë Vendim kofinancohet projekti IPA për bashkëpunim ndërkuftar Maqedoni – Kosove " Turizmi –Dera e hapur për bashkëpunim ndërkuftar". Vlera e përgjithshme e këtij projekti është 275.909,00 Euro ku Komuna e Gostivarit kofinancon 15% të kësaj vlere ose 41.866,00 Euro, të cilën vlerë pas përfundimit të projektit do të kthehen në buxhet të komunës së Gostivarit nga Ministria e vetëqeverisjes lokale.

⁸³ Po aty, Numri 5 30.07.2014 Faqja 128 ,129

⁸⁴ Po aty, Numri 6 25.09.2014 Faqja 9 ,10

1.6 Bashkëpunimi i Komunës së Gostivarit me OJQ -të

Kryetari i Komunës së Gostivarit, për shpallje të Deklaratës për bashkëpunim të Këshillit të Komunës me Komisionin për marrëdhënie midis Bashkësive në datë:29.01.2010.

Për shpalljen e PROGRAMIT për financim të organizatave jo-qeveritare dhe humanitare : PROGRAM për financim të organizatave jo-qeveritare dhe humanitare, i cili ndahet në pesë pjesë, edhe atë:

I. HYRJE

Me programin për financimin e organizatave jo-qeveritare dhe humanitare dhe aktiviteteve të shoqërisë civile me karakter shoqëror dhe humanitar për vitin 2014, përcaktohen qëllimet dhe aktivitetet si dhe lartësia e mjeteve për financimin e tyre, si dhe kriteret të cilat duhet ti plotësojnë palët që aplikojnë. Programi i definon qëllimet e politikës së mbështetjes të shoqërisë civile së komunës së Gostivarit të cilat duhet ti përmbushin bartësit e aktiviteteve me karakter shoqëror, apo, ata të cilët janë në funksion të zhvillimit të shoqërisë civile në komunën e Gostivarit për vitin 2014.

Me qëllim të nxitjes së aktiviteteve shoqërore dhe zhvillimit të shoqërisë civile si pjesë e rëndësishme e Komunës dhe në interes të qytetarëve të saj, shpall program për financimin e OJQ-ve dhe shoqatave duke pranuar aplikimet e tyre në vazhdimësi. Me këtë Program, në bazë të kriterëve për financim të programeve dhe projekteve, përcaktohet mbështetja që do të jep Komuna sektorit civil, OJQ-ve dhe organizatave humanitare.

II. QËLLIMET

Përcaktimi dhe implementimi i këtij Programi ka për qëllim për të përmbushur objektivat specifike që do të rris zhvillimin shoqëror të Komunës dhe promovimin e sistemit demokratik të sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve përmes sektorit civil, OJQ-ve dhe organizatave humanitare në vendimmarrjen e politikave të pushtetit lokal.

Në këtë kontekst numërohen qëllimet si në vijim :

- Të krijoj kushte për jetë të begatshme, kualitative, në nivel të komunës së Gostivarit.
- Zhvillim demokratik të shoqërisë në Komunën e Gostivarit.

- Nxitja dhe afirmimi i diversitetit etnik dhe ndryshimeve kulturore.
- Përkrahje e programeve dhe projekteve që janë në shërbim të përmirësimit të jetës së qytetarëve.
- Përkrahje dhe promovim të projekteve dhe programeve të cilat janë në hap me trendin kulturor evropian dhe botëror.
- Përkrahje e projekteve që ndihmojnë institucionet për të qenë më afër qytetarëve.
- Përkrahje e iniciativave dhe projekteve që mbështesin politika për mbrojtjen e ambientit jetësor.
- Aktivitete të cilat janë në funksion të stimulimit dhe rimëkëmbjes të artizanalëve dhe shkathtësive tradicionale dhe promovim të vendeve të vjetra në qytet.
- Projekte dhe programe të cilat ndihmojnë në përmirësimin e tolerancës ndëretnike, ndërreligjioze.
- Projekte që kanë për qëllim kohezionin social dhe ndihmës për grupet e marginalizuara.
- Projekte për përmirësimin e pozitës shoqërore të personave me nevoja të veçanta.
- Projekte dhe programe që kanë për qëllim të përmirësojnë pozitën e të rinjëve në qytet.
- Projekte dhe programe që ndihmojnë në luftën kundër varfërisë.
- Projekte dhe programe për luftën kundër korrupsionit.
- Projekte dhe programe që kanë për qëllim luftën kundër papunësisë.
- Projekte që promovojnë shëndetin publik.
- Projekte dhe programe që u dalin në ndihmë familjeve dhe personave në nevojë.

Me këto kritere përcaktohet mënyra e financimit të punës dhe aktiviteteve të sektorit civil, OJQ-ve dhe Organizatave Humanitare për projektet me të cilat ata aplikojnë dhe që janë me interes për qytetarët e komunës së Gostivarit.

Mjetet për shumat e planifikuara të programit D0 në bazë të shpenzimeve për mbështetje financiare të organizatave jo-qeveritare dhe humanitare do të shfrytëzohen pas shqyrtimit nga ana e Komisionit për shqyrtim të financimit të projekteve të OJQ-ve dhe organizatave humanitare me vendim të kryetarit të komunës, në bazë të kritereve të theksuara dhe atë:

- Renomeja e organizatës
- Përvoja e deritanishme
- Bashkëpunimi me organizatat e tjera
- Numri i përfituesve nga implementimi i projektit, aktivitetit apo programit.
- Aktivitet e mëparshme të natyrës së njëjtë.
- Shuma e kërkuar.
- Ko-financimi nga vetë organizata.
- Punë voluntare nga ana e anëtarëve të organizatës.
- Përputhshmëria me prioritet e Komunës së Gostivarit.
- Eliminimin e dukurive devijante të shoqërisë nëpërmjet punës së Organizatës.
- Qëndrueshmëria e projektit, aktivitetit apo programit.

- Përfshirja e grupeve të marginalizuara, pakicave etnike apo personave me nevoja të veçanta.
- Ndikimi në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Gostivarit.
- Impakti në përmirësimin e punës së institucioneve publike.

Me hulumtimin në teren dhe mbledhjen e informatave shtesë nga ana e Komisionit për mbështetje financiare të OJQ-ve, dhe me leje të Kryetarit të komunës, sillet vendim për mbështetje financiare të organizatave të caktuara, ngjarjeve, projekteve, programeve, manifestimeve, grupeve të qytetarëve, organizatave rinore apo individëve.

Komuna e Gostivarit do të financojë projekte dhe programe të sektorit joqeveritar të cilët do të edukojnë rininë, do të stimulojnë MC potencialin e tyre krijues dhe do ta zhvillojnë ndjenjën e tyre për tolerancë multietnike dhe trajtimin e identiteteve kulturore të ndryshme. Komuna do të merr pjesë me mjete në implementimin e projekteve apo programeve me interes për qytetarët e saj, do të merr pjesë në hulumtime shoqërore dhe botimin e broshurave që shërbejnë në përmirësimin jetës dhe promovimin e Komunës

Do të merr pjesë me mjete të duhura në realizimin e filmave dokumentarë të cilat e afirmojnë pasurinë e saj natyrore dhe trashëgiminë historike kulturore. Të financoj programe dhe projekte të cilat janë në përputhshmëri me kushtet të përcaktuara me konkurset vjetore për financim të programeve dhe projekteve në sferën e kulturës dhe shoqërisë civile në interes të Komunës së Gostivarit.

Transfere deri te organizatat joqeveritare. Për përkrahje të projekteve, programeve dhe aktiviteteve të organizatave jo-qeveritare me interes për qytetarët e Komunës në Buxhetin për vitin 2014 janë siguruar gjithsejtë 800.000,00 den. Vlera minimale e shpenzimit për nxitje të zhvillimit të shoqërisë dhe sektorit joqeveritar në nivel lokal do të jetë 10.000 denarë, ndërsa vlera maksimale 60.000 denarë, gjatë pagesës individuale. Në përputhshmëri me kriteret e lartpërmendura dhe shqyrtimet nga ana e komisionit, Kryetari përmes, MC aktvendimit do të mbështesë organizatat joqeveritare me mjete financiare.

→ Në raste të jashtëzakonshme, për shembull, kur organizata gjendet në një gjendje të rëndë financiare ose ka ambicie për të përparuar, Këshilli ka të drejtë të posaçme për të vendosur për pagesë një shumë më të lartë nga të parashikuarat.

Kryetari i Komunës kujdeset dhe e siguron implementimin e kësaj programe. Komisioni i veçantë e ndjek implementimin e kësaj programe, merr iniciativa, jep mendime dhe dorëzon propozime në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe aktiviteteve të programuara.⁸⁵

⁸⁵ “Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” Numri 1 27.01.2014 Faqja 35 ,36,37,38,39,40,41.

SHQYRTIMET PËRFUNDIMTARE

Për t'iu përgjigjur detyrimit studentor në lidhje me punimin unë vendosa që këtë ta bëj në një institucion shtetëror edhe atë në Komunën banor i së cilës jam edhe unë, pra në Komunën e Gostivarit. Ajo që më shtiu të vendos që punimin ta bëjë në organet e Komunës ishte fakti se aty unë mundë të gjeja informacione dhe tregues të ndryshëm, të cilët kanë qenë edhe objekt i studimit tonë të programit studimor të cilin e kemi ndjekur përgjat këtyre viteve.

Si përfundim mund të them se punimi që e kam përgatit paraqet një përvojë për mua e cila do të më shërbej në të ardhmen dhe do të jetë një faktor shtytës për studimet dhe kërkimet e mia. Gjithashtu pata rastin që të bëj një krahasim në mes njohurive që i kam përfituar në studime dhe punëve të cilat na presin në jetën e përditshme konkretisht në Komunën e Gostivarit.

Sa i përket vlerësimit tim në lidhje me cilësinë e funksionimit dhe nivelin e profesionalizimit të organeve të Komunës konkretisht të të punuarëve në kuadër të sektorëve, unë pash se ekziston një profesionalizëm ndaj ushtrimit të deyrave. Kjo mund të argumentohet me faktin se punësimet bëhen në bazë të kriteriumeve të drejta duke u bazuar në nevojat dhe nivelin e kualifikimit që nevojitet për punet përkatëse. Rekomandim im do të ishte që në parashikimin e nevojave për administrator të ardhshëm, tu kushtohet vëmendje e veçantë nevojave dhe kërkesave të sektorëve përkatës dhe të kujdesemi që Komunën ta udhëheq administratë e pëgatitur mirë në rrafshin profesional.

Që nga organizimi i ndarjes së parë territoriale, në vitin 1996, Komuna e Gostivarit konsiderohet njësi e vetëqeverisjes lokale, në të cilën qytetarët e realizojnë të drejtën e vetëqeverisjes lokale, përmes përfaqësuesve të zgjedhur në organet e Komunës dhe me pjesëmarrje direkte në vendimmarrje. Organizimi dhe funksionimi i Komunës së Gostivarit rregullohet me Statutin e Komunës dhe i kryen kompetencat e përcaktuara me ligj dhe me Statut.

Komuna e Gostivarit brenda kompetencave të saj, ka investuar dhe realizuar projekte në fusha të ndryshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha vendbanimet pa dallim lokaliteti, por në bazë të përqindjes së pagesës së tatimit në infrastrukturën rrugore, në arsim aty ku ishte nevoja, kurse infrastruktura nëntokësore varësisht nga aktiviteti i qytetarëve dhe gatishmëria e tyre për kofinancim.

LITERATURA

Aliu, A.; Qeverisja lokale në Europën Juglindore me vështrim në IRJ të Maqedonisë, (Punim i Magjistraturës), Prishtinë, 2003.

Aliu, A.; Procesi i decentralizimit dhe vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë pas Marrëveshjes kornizë të Ohrit, (Punim doktore), Tetovë, 2008.

Aliu A., Stavileci E.: Qeverisja lokale, Tetovë-Prishtinë, 2009.

Alan Norton, International Handbook of Local and Regional Government, Edëard Elgar, 1994

Bajrami, Arsim: E drejta kushtetuese, Libri II, Prishtinë, 1996

Farcas, Mihail.; “Pushtetet lokale në Europën Qendrore e Lindore si dhe në komunitetin e shteteve të pavarura (Instituti për vetëqeverisje lokale dhe shërbime publike)“, Budapest, 1994

Gelevski, S. ;Naum, G. ; Borçe, D. : Upravno pravo, Shkup, 1997

Hoxha, Artan.; Pushteti vendor në Shqipëri; Stabilisation of Local Government and Public service reform; (Instituti për vetëqeverisje lokale dhe shërbime publike); Budapest; 2000

Ivanisevic, Stjepan.; Glavni problemi i moguće pravci reforme lokalne samouprave u Hrvatskoj;1999

Mitkov, V.: Ustavot i lokalnata samouprava, Shkup, 1998.

Saliu, Kurtesh: E drejta kushtetuese, Prishtinë, 1998.

Stavileci, Esat: Hyrje në shkencat administrative, Prishtinë, 1997.

Polozhani B.,Stavileci E.,Dobjani E., Salihu L.: E drejta administrative, Tetovë, 2010.

Svetomir, Shkariç: Ustavno pravo, Libri II, Shkup, 1995

Todorovski, Ilija: Lokalna samouprava vo Anglia, SAD, i Jugoslavija, Shkup, 1991.

Todorovski, Ilija: Sovremeni trendovi na lokalnata samouprava vo neкои Evropski drzavi, Shkup, 2002

Doracak: për Kryetarët dhe Këshillat e komunave në R.M,botues BNJVL,2005

Aziri E.,Abdullahi J.,Pajaziti A.,Memeti M.: Shteti i së drejtës dhe reformat në administratën publike: Rasti Maqedoni-përmbledhje kumtesash shkencore,Tetovë,2008

Abdullai, Jonuz: Politika dhe politikat publike, Tetovë,2010

Aziri, Etem: Sociologjia, Tetovë,2007

Dobjani, Ermir: E Drejta Administrative, Tiranë,2004

Mersim Maksuti, E Drejta Kushtetuse e Republikës së Maqedonisë,Tetovë,2010

Karta Europiane për Vetëqeverisje Lokale, Strazburg, 1985

Kodi zgjedhor i Republikës së Maqedonisë

Ligji mbi administratën publike, Shkup, 1990

Ligji mbi finansimin e nevojave të përbashkëta, Shkup, 1991

Ligji mbi territorin e komunave, Shkup, 1991

Ligji mbi buxhetin e republikës, Gazeta zyrtare e R.M.-së nr. 35/01

Ligji mbi vetëqeverisjen lokale, Gazeta zyrtare e R.M-së, nr. 52/95, 5/02

Ligji mbi vetëqeverisjen lokale të Qytetit të Shkupit, 1996

Ligji për planifikim hapësinor dhe urban, Gazeta zyrtare e R.M.-së nr. 4/96, 28/97, 18/99, 53/01 dhe 45/02

Statuti i Komunës së Gostivar, 2006

Rregullore e Komunes se Gostivar

Strategjia e decentralizimit dhe autonomisë vendore, Tiranë, 1999

Ligji për organizimin dhe punën e organeve shtetërore, Shkup 2000

Ligji mbi finansimin e vetëqeverisjes lokale, Gazeta zyrtare e R.M.-së nr. 61/04

Ligji për Qytetin e Shkupit, Gazeta zyrtare e R.M.-së nr. 55/04

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në R.M ëëë.dik.mk.

Proceset e Integritimit Euroatlantik dhe Republika e Maqedonisë – Nazmi Maliqi